# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5626
E hënë, 12 nëntor 2018
çmimi 0.40 €


## Shkëlzen Maliqi: Dalja e Listës Serbe në opozitë paraqet sfidë serioze për Qeverinë

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA TAKUAR NË PARIS PRESIDENTIN AMERIKAN DONALD TRUMP DHE KANCELAREN ANGELA MERKEL FAQE 4-5

# Thaçi: Trumpi mbështet 100 për qind marrëveshjen Kosovë - Serbi



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë mbështetje të fuqishme nga presidenti amerikan Donald Trump për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Pas takimit me presidentin amerikan, Thaçi ka thënë se njeriu më i fuqishëm në botë 100 për qind mbështet arritjen e marrëveshjes ligjërisht të detyrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka treguar se me Trumpin është pajtuar për nevojën për ta zgjeruar paqen dhe pajtimin në Ballkanin Perëndimor. Në Paris të Francës Thaçi ka pasur edhe një takim me kancelaren gjermane Angela Merkel

FLET PËR "EPOKËN E RE", HASAN UKËHAXHAJ

## Synimi im ishte ngritja e vetëdijes kombëtare te nxënësit



Profesori dhe veprimtari i çështjes kombëtare, Hasan Ukëhaxhaj, në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" flet për vitet e fëmijërisë dhe rinisë së vet, për punën prej profesori të gjuhës dhe letërsisë shqipe, për veprimtarinë politike në kuadrin e lëvizjes ilegale, për protestat e vitit '81, për bashkëpunimin me të ndjerin Adem Demaçi, për vuajtjen e dënimit me burg prej dhjetë vjetësh dhe për emërimin e tij zëvendësministër i Arsimit në Qeverinë e Përkohshme të udhëhequr atëkohë nga Hashim Thaçi. Ukëhaxhaj ka treguar se, përveç përpjekjes për t'i pajisur nxënësit me njohuri sa me të gjëra nga fusha që e mbulonte lënda Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, synim në atë kohë kishte ngritjen e vetëdijes kombëtare te nxënësit FAQE 4



## Hoxhaj: Nëse nuk liberalizohen vizat do ta kushtëzojmë dialogun

FAQE 3

## AKTUALE

THAÇI, BASHKË ME LISTËN SERBE, NË KËRKIM TË NJË QEVERIE TË RE QË MBËSHTET PROJEKTIN PËR KORRIGJIM TË KUFIRIT! F. 12



Bilall SHERIFI

KOSOVA ASNJËHERË NUK DO TA HARROJË SAKRIFICËN DHE KONTRIBUTIN E USHTARËVE BRITANIKË F. 6

ASAMBLISTJA E LDK-së NË PRISHTINË KALON NË AAK F. 6

## EKONOMI

RRITEN SHPENZIMET PËR PAGA DHE MËDITJE PËR 26 MILIONË EURO F. 9

RRITEN GJOBAT PËR ATA QË U SHESIN ALKOOL DHE DUHAN PERSONAVE NËN 18 VJEÇ F. 8




## SPORT

PRISHTINA RUAN KRYESIMIN, LLAPI E MPOSHTI KAMPIONEN F. 16

DARDANA, SIGURT DREJT LIGËS SË PARË F. 17


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Meta pritet me nderime nga presidenti francez Macron

TIRANË, 11 NËNTOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta është pritur të dielën nga homologu i tij francez, Emmanuel Macron, në Pallatin Elize.
Vizita e Metës në Francë bëhet me rastin e 100-vjetorit të Armëpushimit të Luftës së Parë Botërore dhe Forumit të Paqes, ku marrin pjesë shumë liderë botërorë.
"Kënaqësi të pritesha sot në Pallatin Élysée nga presidenti Emmanuel Macron dhe Zonja e Parë Brigitte Macron në kuadër të ceremonisë madhështore të organizuar me rastin e 100-vjetorit të Armëpushimit të Luftës së Parë Botërore dhe Forumit të Paqes. Në nderim të paqes e lirisë dhe në respekt të sakrificave dhe të rënëve gjatë Luftës së Parë Botërore, si një mësim për të qëndruar së bashku rreth vlerave morale të popujve, vlera që na detyrojnë të punojmë me përgjegjësi për një botë në paqe dhe një shoqëri në themel të cilës të qëndrojnë harmonia, miqësia e respekti i ndërsjellë", shkruan presidenti në Facebook.



# Hoxhaj: Nëse nuk liberalizohen vizat do ta kushtëzojmë dialogun



Zëvendëskryeministri në Qeverinë e Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë pse do të duhej t'i besojmë BE-së, që ajo do të ketë instrumente që ta bindë Serbinë që ta njohë Kosovën, nëse Bashkimi Evropian nuk është në gjendje t'i përmbushë premtimet në raport me liberalizimin e vizave kur ne i kemi përmbushur të gjitha kriteret

PRISHTINË, 11 NËNTOR- Zëvendëskryeministri në Qeverinë e Kosovës, Enver Hoxhaj, ka thënë se Kosova duhet ta kushtëzojë dialogun me Serbinë, nëse nuk liberalizohen sa më parë vizat për qytetarët e Kosovës. "Kam menduar se do të ndodhë një lloj politike e kushtëzimit, jo një lloj tërheqje. Në deklaratat e mia asnjëherë nuk ka pasur formulime për tërheqje, por nëse Bashkimi Evropian nuk është në gjendje t'i përmbushë premtimet në raport me liberalizimin e vizave dhe ne i kemi përmbushur të gjitha kriteret, nga kriteri i parë deri në kriterin e 95-të, dhe tash i mbetet BE-së që të marrë vendim sa i takon mundësisë së lëvizjes së lirë në vitin 2019. Atëherë pse do të duhej t'i besojmë BE-së, që ajo do të ketë instrumente që ta bindë Serbinë që ta njohë Kosovën. Duhet të jemi realistë në një qasje të tillë", ka thënë Hoxhaj në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë". Ai ka folur edhe për taksën që Kosova ua ka vendosur mallrave serbe, duke thënë se mund të ketë edhe masa të tjera nëse Serbia vazhdon të sillet me agresivitet ndaj Kosovës. Hoxhaj ka folur edhe për mungesën e njohjeve dhe pasivitetin e diplomacisë së Kosovës në këtë drejtim.
Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka theksuar se nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme as në vitin 2019. "Forcat politike në Kosovë, institucionet e Kosovës, liderët në institucione dhe në opozitë, duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi meqë Bashkimi Evropian e ka kushtëzuar të ardhmen e Serbisë përmes normalizimit të raporteve me Kosovën. E ardhmja e Serbisë në BE kalon përmes Prishtinës. Duhet ta përdorim këtë shans të mundur. Në këtë drejtim, nuk mendoj se në 2018-ën ose 2019-ën duhet të flitet për zgjedhje. Nuk është detyra e partive politike të organizojnë performanca zgjedhore çdo vit, por duhet t'i përmbushim disa prej pritjeve, sidomos kur e kemi dialogun, kur e kemi liberalizimin e vizave, kur e kemi FSK-në. Është kërkesa më absurde të mendohet të ketë zgjedhje të parakohshme", ka thënë zëvendëskryeministri Hoxhaj.

## Basha: Dokumente për vjedhjen e kryehajdutit

TIRANË, 11 NËNTOR - Kreu i Partisë Demokratike ka sfiduar shefin e qeverisë teksa paralajmëroi se sot (e hënë) do të nxjerrë dokumente, të cilat sipas tij vërtetojnë skemën e vjedhjes në zonën e Astirit.



"Kryehajduti për t'i mbushur xhepat e tij nuk ndalet para lotëve të fëmijëve, as para shtëpive të njerëzve dhe as para simboleve kombëtare. Pse u hoq Shqiponja? Ç'aferë fshihet pas shkatërrimit të 300 shtëpive te Astiri? Nesër me fakte e dokumente skema e hajdutërisë te Unaza e Re", shkruan Basha në Twitter

## Gruevski, "i pakapshëm" për të pranuar vendimin për burg

SHKUP, 11 NËNTOR - Institucionet tani dy ditë nuk mund ta gjejnë ish-kryeministrin e Maqedonisë, Nikolla Gruevski për t'i dorëzuar vendimin refuzues për shtyrjen e vuajtjes së dënimit prej dy vjet burgim.
Gruevski duhet personalisht ta pranojë vendimin dhe menjëherë të shkojë në burg për vuajtjen e dënimit për shpërdorim të detyrës në rastin e blerjes së makinës luksoze qeveritare në vlerë prej 600 mijë euro. Sipas ligjeve ekzistuese, nëse edhe sot (e hënë) nuk arrihet t'i dorëzohet vendimi, atëherë do të shpallet fletarrestim për dërgimin e tij në burg.
Në disa media në gjuhën maqedonase është spekuluar mbi mundësinë e largimit të tij nga Maqedonia, por kjo nuk është konfirmuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.
Para se t'i refuzohet kërkesa për shtyrjen e vuajtjes së dënimit, Kuvendi i Maqedonisë nuk kishte arritur të siguronte dy të tretat e votave për t'i hequr mandatin e deputetit.
Për heqjen e mandatit kishin votuar 58 deputetë, kurse kundër 29 deputetë. Nisma ishte paraqitur në Komisionin për Çështje të Mandateve, pas informimit se Kuvendi ishte njoftuar gjykata për dënimin e ish-kryeministrit Gruevski me dy vjet burgim.
Shumica parlamentare kishte kërkuar marrjen e mandatit të tij me arsyetimin se "Nikolla Gruevski nuk është i denjë të ushtrojë detyrën e deputetit".
Ndërkohë, ndaj Gruevskit po zhvillohet edhe disa procese tjera gjyqësore. Ai po gjykohet për shpërdorime të tjera të detyrës zyrtare, për mashtrime zgjedhore, dhunë të porositur ndaj ish-drejtuesve të opozitës në një komunë të Shkupit, e keqpërdorime tjera financiare.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka takuar në Paris presidentin amerikan Donald Trump dhe kancelaren Angela Merkel

# Thaçi: Trumpi mbështet 100 për qind marrëveshjen Kosovë - Serbi

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë mbështetje të fuqishme nga presidenti amerikan, Donald Trump, për marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Pas takimit me presidentin amerikan, Thaçi ka thënë se njeriu më i fuqishëm në botë 100 për qind mbështet arritjen e marrëveshjes ligjërisht të detyrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka treguar se me Trumpin është pajtuar për nevojën për ta zgjeruar paqen dhe pajtimin në Ballkanin Perëndimor. Në Paris të Francës Thaçi ka pasur edhe një takim me kancelaren gjermane Angela Merkel



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se ka marrë mbështetje 100 për qind nga presidenti amerikan, Donald Trump, për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë. Nëpërmjet llogarisë së vet në "Twitter", Thaçi ka treguar se homologun e vet amerikan e ka takuar të shtunën në mbrëmje në Paris, teksa ka marrë pjesë në ceremoninë e organizuar me rastin e 100-vjetorit të mbarimit të Luftës së Parë Botërore.

Shefi i shtetit ka vlerësuar se Kosova i është mirënjohëse Amerikës për mbështetjen e vazhdueshme. "Mbrëmë (të shtunën) kam pasur një takim të rëndësishëm me presidentin e ShBA-së, Donald Trump. Ai shprehi 100 për qind mbështetje për arritjen e marrëveshjes ligjërisht të detyrueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. I jam mirënjohës për mbështetjen e tij dhe të Amerikës", ka shkruar Thaçi në "Twitter".

Më pas, presidenti ka shkruar sërish në "Twitter", duke postuar edhe një fotografi të takimit me shefin e Shtëpisë së Bardhë. Ai ka deklaruar se me presidentin e ShBA-së, Donald Trump, janë pajtuar për ta zgjeruar paqen dhe pajtimin në Ballkanin Perëndimor, duke arritur marrëveshjen përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Në këtë ditë të 100-vjetorit të armëpushimit, duke përkujtuar fundin e Luftës së Parë Botërore, ne u pajtuam me presidentin Donald Trump për nevojën për ta zgjeruar paqen dhe pajtimin në Ballkanin Perëndimor, duke arritur marrëveshjen përfundimtare dhe gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë, duke bërë të mundur që Republika jonë të bashkohet me NATO-në, OKB-në dhe BE-në", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Twitter".

Në Paris presidenti Thaçi është pritur nga presidenti francez Emmanuel Macron.

Shefi i shtetit e ka falënderuar Francën që e ka nderuar Kosovën në këtë ceremoni sikurse shtetet e tjera. "E falënderoj presidentin Macron për pritjen e sotme miqësore. Mirënjohës për Francën, e cila e ka nderuar Kosovën njësoj sikur të gjitha shtetet e tjera pjesëmarrëse në shënimin e 100-vjetorit të përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Kjo ishte një mundësi shumë e mirë për të biseduar me liderët botërorë për bashkëpunimin dhe forcimin e paqes në rajonin tonë dhe në botë", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook".

Gjatë qëndrimit në Paris, presidenti Thaçi ka dekoruar me "Urdhrin e Lirisë" diplomatin francez Frederic Baleine, në shenjë nderimi për kontributin dhe angazhimin e tij për shtetin e Kosovës, që nga Konferenca e Rambujesë. Sipas presidentit, në rrugëtimin drejt lirisë dhe pavarësisë Kosova e ka pasur gjithmonë mbështetjen e lidershipit të Francës dhe diplomatëve të saj.

Në ceremoninë e organizuar me rastin e 100-vjetorit të mbarimit të Luftës së Parë Botërore në Prasi ka marrë pjesë edhe zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli. Në profilin e vet në "Facebook", Pacolli ka shkruar se kjo ceremoni ka qenë rast i mirë për t'i takuar burrështetasit e dhjetëra shteteve të botës. "Me ftesë të autoriteteve më të larta franceze po marrë pjesë ceremoninë e organizuar me rastin e 100-vjetorit të mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Mundësi e mirë për t'i takuar homologët e mi dhe burrështetas nga mbi 50 shtete botërore", ka shkruar Pacolli.

## Thaçi takohet edhe me Merkelin në Paris, merr përkrahjen e saj për dialogun

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në Paris të Francës ka pasur edhe një takim me kancelaren gjermane Angela Merkel. Thaçi ka bërë me dije se gjatë këtij takimi ka biseduar me Merkelin rreth mundësisë së arritjes së marrëveshjes në mes të Kosovës e Serbisë, për të cilën ka theksuar se mbështetja e Gjermanisë është vendimtare për vendin. "Kisha një bisedë të shkurtër edhe me kancelaren gjermane Angela Merkel në Paris. Ne diskutuam për mundësinë për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse paqësore për Kosovën dhe Serbinë. Ne të dy u pajtuam se mbështetja e Gjermanisë është vendimtare për këtë marrëveshje dhe anëtarësimin tonë në BE", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Twitter".

## Macroni bën thirrje që bota të bashkohet për të luftuar për paqe

Për ta shënuar 100-vjetorin e përfundimit të Luftës së Parë Botërore, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka mirëpritur të dielën rreth 70 liderë botërorë në Paris. Në fjalimin e tij, në "Harkun e Triumfit", presidenti francez u ka bërë thirrje liderëve botërorë që t'i bashkojnë forcat për të luftuar për paqe. "Le të ndërtojmë shpresat tona në vend se të mbetemi pengje të frikës kundrejt njëri-tjetrit. Patriotizmi është krejtësisht e kundërta e nacionalizmit", ka thënë Macron.

Ai ka thënë se këtë duhet ta bëjnë për gjeneratat e ardhshme. "Shkatërrimi i kësaj shprese me një magjepsje për tërheqje, dhunë apo dominim, do të ishte një gabim për të cilin gjeneratat e ardhshme do të na bëjnë ne përgjegjës", është shprehur presidenti francez Emmanuel Macron.

Armëpushimi për përfundimin e Luftës së Parë Botërore ka hyrë në fuqi më 11 nëntor 1918, duke i dhënë fund kështu luftës katërvjeçare, që la të vdekur të paktën 10 milionë ushtarë dhe miliona civilë. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, kancelarja gjermane Angela Merkel, presidenti rus Vladimir Putin, ai i Turqisë, Rexhep Tayyip Erdogan, kanë qenë disa prej udhëheqësve botërorë që kanë marrë pjesë në këtë ceremoni.





## Vuçiqi dhe Merkeli biseduan për Kosovën

PARIS, 11 NËNTOR - Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, u takuan në Paris, ku morën pjesë në shënimin e 100-vjetorit të përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Në një komunikatë nga Presidenca e Serbisë, thuhet se dy zyrtarët biseduan për marrëdhëniet dypalëshe, bashkëpunimin ekonomik, situatën në rajon dhe integrimin evropian të Serbisë.

Vuçiqi, siç thuhet, e informoi Merkelin për rrjedhën e dialogut me Kosovën për normalizimin e marrëdhënieve, si dhe për veprimet e fundit të Prishtinës që kanë të bëjnë me vënien e taksës doganore mbi mallrat që importon nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

Javën e kaluar Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për vendosjen e taksës 10 për qind mbi të gjitha importet me prejardhje nga Serbia dhe Bosnja. Kjo ka bërë që Vuçiqi, dy ditë më vonë, të paralajmërojë se nuk do të takohet për bisedime me homologun e Kosovës, Hashim Thaçi, derisa të jetë në fuqi taksa.

Në takim me Merkelin, Vuçiqi e informoi atë për, siç thuhet në komunikatë, përmirësimin e gjendjes ekonomike në Serbi dhe e falënderoi për rritjen e numrit të investimeve gjermane në Serbi. Merkeli, në anën tjetër, e mirëpriti "suksesin ekonomik të Serbisë" dhe theksoi se "dëshiron të ndihmojë që në rajonin e Ballkanit Perëndimor të ruhen paqja dhe stabiliteti".

Flet për "Epokën e re", Hasan Ukëhaxhaj

# Synimi im ishte ngritja e vetë

Profesori dhe veprimtari i çështjes kombëtare, Hasan Ukëhaxhaj, në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re" flet për vitet e fëmijërisë dhe rinisë së vet, për punën prej profesori të gjuhës dhe letërsisë shqipe, për veprimtarinë politike në kuadrin e lëvizjes ilegale, për protestat e vitit '81, për bashkëpunimin me të ndjerin Adem Demaçi, për vuajtjen e dënimit me burg prej dhjetë vjetësh dhe për emërimin e tij zëvendësministër i Arsimit në Qeverinë e Përkohshme të udhëhequr atëkohë nga Hashim Thaçi. Ukëhaxhaj ka treguar se, përveç përpjekjes për t'i pajisur nxënësit me njohuri sa me të gjëra nga fusha që e mbulonte lënda Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, synim në atë kohë kishte ngritjen e vetëdijes kombëtare te nxënësit



EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 11 NËNTOR - **"Epoka e re":** *A ju kujtohet, në këtë moshë, diçka nga fëmijëria dhe vitet e rinisë suaj?*

**Ukëhaxhaj:** Nga e para, pak e mbaj në mend '47-shin, kur pushtetarët ua patën zbrazur koshat e drithit fshatarëve, pra edhe familjes sime, për t'i ushqyer edhe kolonët e vjetër e të rinj. Aksioni më është rrënjosur në kujtesë edhe nga kujtimet e njerëzve që e kishin përjetuar më thellësisht, bashkë me përpjekjet që i kishin bërë për ta përballuar atë vit zie, siç e quanin ata. E mbaj mend edhe mësuesin e parë, emrin e të cilit edhe mund ta kisha harruar, sikur të mos ndodhte diçka që do ta them më poshtë. Edhe aksioni për mbledhjen e armëve ishte i paharrueshëm edhe për fëmijët e klasave të para të shkollës fillore. Në çdo familje vërehej ankthi të cilin të rriturit e shprehnin kryesisht me pëshpëritje.

Emrin e Adem Demaçit e mësova kur ia lexova romanin "Gjarpërinjtë e gjakut" që ia kishte dhënë një shok i klasës së tij dajës tim Zenun Gjocajt, i cili që nga ato vite qe dhe mbeti pjesë e familjes sonë. Ndërkaq, në mëngjesin e një dite të vjeshtës së '63-s e dëgjova bisedën e dy nxënësve nga Gjakova të cilët i vijonin mësimet në shkollën ekonomike në Pejë, pra gjatë udhëtimit me autobus, se në mesin e të arrestuarve ishin edhe Hasim Vula dhe Kadri Kusari. I pari ishte mësuesi im, të cilin e përmenda më sipër, ndërkaq për të dytin dëgjoja nga bashkëvendësit e mi që vijonin mësimet në Normalen e Gjakovës. Mësuesi im i parë, ndonëse nuk e pashë kurrë më, mbeti i pashlyeshëm në kujtesën time e të dytin e takova për herë të parë e të fundit në shtëpinë e një shoku, i cili sapo kishte filluar të punojë në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" në Deçan. Për vdekjen e tij mësova në burgun e Nishit.

Duhet t'i kthehemi shkollimit të mesëm për të theksuar se në verën e vitit '63 i patën larguar nga procesi mësimor dy mësimdhënësit e gjimnazit të Pejës: Riza Bicaj dhe Rexhep Podrimen. Edhe ky akt i pushtetit të atëhershëm nuk mbeti pa lënë gjurmë në botën time shpirtërore, sepse si njëri, ashtu edhe tjetri përpiqeshin për t'i ndërgjegjësuar nxënësit në aspektin kombëtar.

**"Epoka e re":** *Cilët janë hapat e tjerë pasi që e kryet gjimnazin?*

**Hasan Ukëhaxhaj:** Punova mësues i klasës së katërt fillore në të njëjtën shkollë ku e kreva tetëvjeçaren. Pastaj u regjistrova në Fakultetin Filozofik të Prishtinës - Dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Pasi i kreva dy vjetët e para, fillova të punoj në Shkollën Fillore "Drita" të Gramaçelit, njëkohësisht i vazhdoja studimet e shkallës së dytë. Në majin e vitit 1971 i kreva studimet dhe në shtator e fillova punën në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" të Deçanit.

**"Epoka e re":** *A mund të na përshkruani veprimtarinë tuaj në arsimin fillor dhe të mesëm?*

**Hasan Ukëhaxhaj:** Së pari duhet thënë se mësuesit që punojnë me nxënësit e katër klasave të para të shkollës fillore përballen me vështirësi objektive, sepse asnjëri nuk mund të jetë i përgatitur njësoj për të gjitha lëndët e parashikuara me program. Prandaj, po them pa kurrfarë ngurrimi, se nuk kam mundur t'i përgatis nxënësit si në lëndën e gjuhës shqipe, të historisë apo të gjeografisë edhe në lëndën e muzikës, të vizatimit e të ndonjë tjetre. Dhe nuk jam brengosur duke shpresuar se të tjerët me përgatitjen adekuate do t'i plotësojnë zbrazësitë e mësuesit. Ndërkaq, në shkollën fillore të Gramaçelit lëndën Gjuhë e letërsi shqipe ua mësova nxënësve nga klasa e gjashtë deri në të tetën. Siç e thashë më lart, në vitin shkollor 1971/72 fillova të punoj në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" të Deçanit. Që nga fillimi e derisa u arrestova, pas një dekade, kam punuar me përkushtim profesional e kombëtar që t'i edukoj dhe t'i arsimoj në të dy drejtimet e theksuara. Kur u vendosëm në objektin e ri vendosa që organeve drejtuese të shkollës t'ua shpreh gatishmërinë time për të punuar në bibliotekë pa kurrfarë kompensimi material. Përveç përgjigjes pozitive m'u dha edhe autorizimi për ta pajisur bibliotekën me titujt dhe ekzemplarët e mjaftueshëm sipas planprogramit të gjuhës shqipe.

Vitet e '70-ta për Kosovën dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi përbëjnë një kapitull të veçantë sa i përket zhvillimit të arsimit, shkencës dhe kulturës në përgjithësi falë bashkëpunimit midis Kosovës dhe Shqipërisë. Prandaj, krahas institucioneve të tjera, edhe shtëpia botuese "Rilindja" e kreu misionin e vet në mënyrën më të mirë të mundshëm: i botoi dhe i ribotoi të gjitha veprat e shkrimtarëve të traditës dhe të atyre bashkëkohorë, të Kosovës dhe të Shqipërisë, prandaj edhe unë kisha pse t'ia mësyj asaj shtëpie. Përveç literaturës që kërkohej me planprogramet e të gjitha viteve porosita gjithçka që, përveç të tjerash, do t'i bënte nder bibliotekës e, para së gjithash, edhe gjimnazit. Pra, arsyen, se nuk e kishte gjetur veprën e Naimit, të De Radës, të Nolit, të Migjenit e të shkrimtarëve të tjerë e solla në zero. Po theksoj se çfarë synonte të arrijë udhëheqja jugosllave përmes bashkëpunimit midis Kosovës dhe Shqipërisë, këtu nuk është vendi për ta shtjelluar, por duhet thënë kishte një prapavijë. Pra, siç thotë populli, "e

# dijes kombëtare te nxënësit



kishte me sherr" dhe sherri e zuri në pranverën e vitit 1981.

Tani, se si ua interpretova veprimtarinë e shkrimtarëve dhe veprat e tyre, mua nuk më takon ta them asnjë fjalë. E dinë ata dhe e kuptuan më mirë kur u ulën në bankat e auditoriumeve universitare. Tash po e them se planprogramin nuk e kam respektuar me fanatizëm, pra shpesh i kam kapërcyer caqet e tij. U kam caktuar ato vepra që mendoja se duhet t'i lexojnë; u lexova në klasë fragmente nga romani "Dimri i madh", poemën "Nënë Shqipëri", pjesë nga "Lahuta e Malësisë" fragmente nga romani "Mërgata e qyqeve" e të tjera. Po i radhis edhe disa prej temave të hartimeve që më kujtohen edhe sot, pasi ishin bërë pjesë e pyetjeve gjatë hetuesisë në burgun e Pejës: "Ti Shqipëri më jep nderë, më jep emrin shqiptar", "Nëntori, spektër i fitoreve tona historike", "Populli shqiptar e ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë" e të tjera si këto. Synimi im ishte që vetëdijen kombëtare te nxënësit ta ngreh në shkallën më të lartë të mundshme. Legjenda e lirisë së vendit, Adem Demaçi, e quajti Esat Mekulin "kopshtari i letrave tona" i cili në vjershën "Populli tim" e skaliti vargun "Këndova edhe kur m'ishte ndalue". Porosinë që ua la brezave plaviani i lavdishëm u përpoqa ta përcjell së paku simbolikisht te nxënësit, duke ua ofruar diçka edhe nga e ndaluara. Rrugëtimin e shumicës prej tyre e kam dëshmi se nuk kisha pas mbajtur "ujë me shoshë". Prandaj po shfrytëzoj rastin që përmes kësaj interviste t'u shpreh mirënjohje publike. Pra, përveç përpjekjes për t'i pajisur nxënësit me njohuri sa më të gjëra nga fusha që e mbulonte lënda Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, qëllimi im kryesor ishte që në vetëdijen e tyre ta mbjell dashurinë ndaj Shqipërisë, t'ua bëj me dije se gjysma e trojeve shqiptare janë të robëruara, prandaj duhet të përpiqemi për t'i çliruar.

Në marsin e '79-s bëra një vizitë dhjetëditëshe në Shqipëri me disa shokë. Pas një kohe organet përkatëse më kërkuan shpjegime. Nuk iu përgjigja thirrjes së tyre. Përveç atyre që u thanë më sipër, edhe kjo çështje ishte një nga pretekstet për të më arrestuar në dhjetorin e '80-s dhe për të më dënuar dy muaj burg me akuzën për propagandë armiqësore. Ky ishte çmimi që e pagova për punën rreth një dekadë në gjimnaz.

**"Epoka e re":** *A mund të na thoni diçka për veprimtarinë tuaj politike në kuadrin e lëvizjes ilegale?*

**Hasan Ukëhaxhaj:** Më 1975 Titoja e vizitoi Kosovën, gjendjen politike të së cilës e vlerësoi stabile. Me atë rast u shpall edhe "Doktor Nderi" i Universitetit të Prishtinës, të cilin e përgëzoi, prandaj edhe e nxiti bashkë me Qeverinë që ta vazhdojnë edhe më tej bashkëpunimin me Shqipërinë. Në anën tjetër, për të tretën herë dënohet Adem Demaçi. Si gurrë frymëzimi dhe si legjendë u materializua me formimin e organizatës "LNÇK". Meqë në radhët e saj më vonë aderuan edhe atdhetarë të tjerë nga viset e tjera shqiptare në Jugosllavi ajo i përfshiu ato vise edhe në emrin e saj të ri.

Në tetorin e '79-s monarku i Kumrovcit erdhi sërish në Kosovë për të parë se ç'fryte do të mblidhte nga të mbjellat e një dekade. U tërbua sepse, duhet pranuar nuk i mungonte intuita, e pa se "në vend të erës do të korrte furtunën", prandaj "i mbathi" ata që mendonte se ia kishin punuar. Por as vetë nuk qe kthyer "i pambathur" nga organizata e sapocekur më lart, e cila edhe vet i pagoi shtrenjtë "thumba e patkonj": U arrestuan e më pas edhe u dënuan disa nga anëtarët e saj, ndërkaq ndër të arratisurit ishte edhe Jusuf Gërvalla. Shkurt, në aspektin organizativ ajo ishte shpërbërë.

Meqë familja e Ismajl Haradinajt kishte pasur miqësi paraprake me atë të Gërvallajve, ai u përcaktua ta gjejë mënyrën për të komunikuar me Jusufin dhe për t'i shprehur gatishmërinë e vet për ta vazhduar veprimtarinë, duke shpresuar se do t'i gjejë edhe bashkëmendimtarët. Propozimin e kishte pritur Jusuf Gërvalla me kënaqësi të veçantë. Me Ismailin njiheshim që nga vitet kur punoja në shkollën fillore të Gramaçelit, prandaj kishte vendosur të ma shtrojë atë që mendonte. Mal, këtu më duhet të jem edhe më rezimues se më sipër, duke u kërkuar ndjesë edhe bashkëveprimtarëve, meqë jam i detyruar që edhe emrat e tyre t'i kapërcej. Por, siç e dinë edhe ata, nuk do të kalojë kohë e gjatë kur puna e secilit do t'i bëhet e njohur opinionit. Prandaj po i bie shkurt. Meqë kishte punuar njëkohësisht edhe me bashkëvendësin, tani më të ndjerë, Dinë Ahmetaj, në shtëpinë e tij, përveç programit e statutit, e lexuam edhe punimin e Jusufit të botuar në "Bashkimi", organ i "Frontit të kuq popullor"... Respekt për heroin e rënë bashkë me vëllanë dhe Kadri Zekën, por dy emrat e propozuar prej tij për anëtarë Komiteti për ne të dy ishin të papranueshëm... I dhashë gajret Ismailit duke i premtuar se problemin do ta zgjidhim. Pas disa javësh e lajmërova se qëllimin e kisha arritur. U pajtua me propozimin që ta takoj me treshen në bibliotekën e gjimnazit. Atyre ua caktova kohën kur do t'i merrja veç e veç. E fillova me Avdullah Hasanmetaj, për të vazhduar me Jashar Salihun, ndërkaq me Shkurte Drita Kuqin u kompletua "ekipi". Pra, "themelin" Komitetit të Deçanit ia vumë në bibliotekën e gjimnazit, "kulmin me dyer e dritare" në shtëpinë e Ismail Haradinajt, nën udhëheqjen e të cilit dhe në saje të një bashkëpunimi korrekt deri në marsin e '81-shit LNÇKVShJ e ripërtërirë, përveç Komitetit të Drenasit, e kishte në prag të formimit edhe atë në Mitrovicë. Ndërkaq celulat i kishte formuar edhe në Gjilan e Besianë. Ndoshta nuk është modeste, por po e theksoj se asnjë shkollë e mesme anekënd Kosovës nuk i ka pasur gjashtë profesorë në Lëvizjen Ilegale siç i pati Gjimnazi i Deçanit.

**"Epoka e re":** *Dëshirojmë ta dimë mendimin tuaj për demonstratat e vitit 1981?*

**Hasan Ukëhaxhaj:** Për mendimin tim që po e jap që në fillim, demonstratat e pranverës së vitit 1981 janë një nga tri majat përmes të cilave gjysma e kombit gjakoi "për të dalë më vete" siç shkroi J. Gërvalla në punimin e cekur më sipër. Ishin majat e gjysmës së dytë të shekullit XX. I filluan studentët e nga një prilli u bashkuan me ta edhe shtresat e tjera të shoqërisë. Ato së pari duhet thënë se i befasuan Prishtinën dhe Beogradin, po ashtu edhe Tiranën. Përtej trekëndëshit të sapocekur, ato e befasuan edhe vetë Lëvizjen Ilegale, e cila arriti të konsolidohet me shpejtësi në kuptimin për t'iu përgjigjur rrethanave të reja, duke u bërë jo pjesë, por edhe udhëheqëse e aksioneve. Përveç ilegalit me megafon në bli, lëviznin edhe të tjerë veprimtarë në mesin e asaj mase, jehona e brohoritjeve të së cilës arrinte edhe përtej skajeve të qytetit. Pra, Lëvizja Ilegale, në kuadrin e së cilës vepronin katër organizata, e dha kontributin e vet duke u dhënë ngjarjeve kohezioni e duhur.

Përveç këtyre që u thanë më sipër, për kërshërinë që e shprehet në pyetjen tuaj, po i shtoj edhe disa rreshta. Po filloj me trekëndëshin e cekur më sipër. Së pari, Serbia alias Jugosllavia demonstratat i kualifikoi asgjë më pak se kundërrevolucion, Kosova, ndrydhu-çndrydhu, pshtillu-çpshtillu, u detyrua ta pranojë verdiktin serbian. Ndërkaq, inteligjencia e saj nuk i mbështeti sepse, siç thekson U. Hoti, do të duhej të shkonte në burg, por as nuk i dënoi sepse nuk mund të dilte kundër veprës që e kishte krijuar vetë. E Shqipëria, përveç përgjigjes flakë për flakë për akuzën e Serbisë, se gjoja ajo kishte dorë, së paku, në inspirimin e tyre e diçka më shumë se kaq, i mbrojti demonstruesit dhe e mbështeti kërkesën e tyre për Kosovën Republikë. Qëndrimi i tillë ishte statisfaksioni më brilant për të rinjtë në radhë të parë, të cilët e kishin sakrifikuar të ardhmen e tyre. Ndërkaq, sa i përket qasjes së mirëfilltë shkencore, mund të thuhet se, krahas vlerësimeve objektive e të matura, nuk mungojnë as të ekzagjeruarat.

Mal, në qershorin e vitit 2011, përveç të tjerave, u mbajt edhe konferenca shkencore kushtuar demonstratave të vitit 1981, në të cilën janë lexuar mbi dyzet kumtesa. E theksova këtë për të dëshmuar se në këtë rast nuk kam pse të vazhdoj më tej.

**(Vijon)**

# Thaçi, bashkë me Listën Serbe, në kërkim të një qeverie të re që mbështet projektin për korrigjim të kufirit



Bilall SHERIFI

Opinionit publik i kujtohet se në mars të këtij viti, në një konferencë për shtyp të mbajtur në presidencën serbe, Lista Serbe bëri publik daljen e saj nga Qeveria e Kosovës. Përveç deklarimit publik, kjo "dalje nga Qeveria e Kosovës" nuk u shoqërua me asnjë dorëheqje të asnjë zyrtari. As zëvendëskryeministri, as ministrat e as zëvendësministrat nuk dorëzuan dorëheqje, por vazhduan t'i merrnin rrogat nga buxheti i Kosovës dhe ruajtën të gjitha përfitimet që lidhen me institucionin e Qeverisë së Kosovës.

Nga reagimet e shumta të asaj kohe do ta veçoja qëndrimin e presidentit të Kosovës, për arsyet që do të theksohen më poshtë. Duke menduar se e ka mbështetjen e Qeverisë, Hashim Thaçi shprehu zhgënjimin e vet për këtë veprim të Listës Serbe dhe deklaroi se "zhvillimet e tilla janë në kundërshtim me angazhimet për dialog për ndërtimin e paqes së qëndrueshme në Kosovë dhe cenimin e përpjekjeve për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë". Madje presidenti i Kosovës nuk u ndal me kaq. Ai bëri ftesë që "të respektohet dhe të ruhet fryma e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe të mbesim të fokusuar në normalizimin e marrëdhënieve, në ndërtimin e fqinjësisë së mirë dhe pajtim".

Zhvillimet e mëvonshme politike, sidomos që nga dalja publike lidhur me negociatat e fshehta në mes të Aleksandër Vuçiqit dhe Hashim Thaçit, e bindën presidentin e Kosovës se nuk e ka mbështetjen e Qeverisë së Kosovës për realizimin e projektit për korrigjimin/shkëmbimin e territoreve me Serbinë.

Qëndrimet parimore rreth kësaj çështjeje të Qeverisë së Kosovës dhe të forcave të tjera politike në vend janë arsye e vetme që bënë Hashim Thaçin të mbajë një qëndrim të ri për "daljen e re" të atyre që, në fakt, nuk kishin dalë fare nga Qeveria e Kosovës!

Ende pa dorëzuar dorëheqje asnjë nga funksionarët e Listës Serbe, Hashim Thaçit nuk iu prit të kthehet nga Parisi, por prej Francës kërkoi nga Qeveria e Kosovës që "të konfirmojë nëse e ka apo nuk e ka shumicën e nevojshme për të qeverisur". Nëse e ka këtë shumicë atëherë Hashim Thaçi jep leje të vazhdohet puna, ndërsa nëse nuk e ka ky "do t'i shikojë mundësitë e interpretimeve të Kushtetutës për t'u dhënë mundësi qeverisjeje atyre që e bëjnë shumicën".

Qëndrimet e ndryshme të Hashim Thaçit për veprimet e njëjta të Listës Serbe nuk kanë shpjegim tjetër pos përpjekje për ta detyruar Qeverinë që ta mbështetë aventurën e tij të rrezikshme të korrigjimit të kufijve!

Kam bindjen e plotë se do të dështojnë të gjitha përpjekjet e Hashim Thaçit që së bashku me Listën Serbe të sjellë në krye të institucionit të Qeverisë së Kosovës njerëz që do ta mbështesin projektin për korrigjim të kufirit!



# Kosova nuk do ta harrojë asnjëherë sakrificën dhe kontributin e ushtarëve britanikë

Kryeministri Ramush Haradinaj mori pjesë të dielën në Ditën e Përkujtimit të Britanisë së Madhe për të gjithë të rënët e saj, në të gjitha luftërat, që nga Lufta e Parë Botërore

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 NËNTOR - "Kosova dhe populli nuk do ta harrojnë asnjëherë sakrificën dhe kontributin e jashtëzakonshëm të Mbretërisë së Bashkuar dhe të ushtarëve britanikë që shërbyen në misionin paqeruajtës në Kosovë", kështu ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në Ditën e Përkujtimit të Britanisë së Madhe për të gjithë të rënët e saj, në të gjitha luftërat, që nga Lufta e Parë Botërore, që u mbajt të dielën në nderim dhe përkujtim të dëshmorëve britanikë, veçanërisht të atyre që humbën jetën në shërbim në Kosovë, ceremoni kjo e organizuar nga Ambasada e Britanisë në Kosovë.

Pasi bëri homazhe pranë pllakës përkujtimore me emrat e ushtarëve britanikë, kryeministri Haradinaj vlerësoi lart ndihmën e pakursyer që Mbretëria e Bashkuar i ka dhënë Kosovës në të gjitha etapat e shtetndërtimit dhe konsolidimit, duke mos harruar edhe kontributin që kanë dhënë ushtarët britanikë që shërbejnë në kuadër të misionit të KFOR-it për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në vendin tonë.

Një fjalë para të pranishmëve e mbajti ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, Ruari O'Connell, i cili tha se sot kujtojnë të gjithë ata që kanë dhënë jetën e tyre për ta mbrojtur Mbretërinë e Bashkuar, në veçanti ata që shërbyen në Kosovë. Të pranishëm ishin edhe ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjeneral Rrahman Rama, ambasadorë të akredituar në Kosovë, pjesëtarë të KFOR-it dhe personalitete të tjera.

## Asamblistja e LDK-së në Prishtinë kalon në AAK

PRISHTINË, 11 NËNTOR (ER) - Asamblistja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Kuvendin Komunal të Prishtinës, Fiknete Bejta, të dielën i është bashkuar Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Lideri i AAK-së, njëherësh kryeministër i vendit, Ramush Haradinaj, e ka pritur në takim asamblisten Fiknete Bejta. "Kënaqësi ta pranojmë sot, në radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, aktivisten dhe asamblisten e Kuvendit Komunal të Prishtinës, Fiknete Bejta. Si një ekonomiste e shquar dhe aktive, Fiknetja ka treguar përkushtim dhe profesionalizëm në angazhimin e saj dhe bashkë presim që ta avancojmë rolin e Aleancës në Asamblenë e kryeqytetit, për t'i çuar përpara projektet që kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve tanë. Mirë se erdhe, Fiknete!", ka Haradinaj pas takimit me asamblisten Fiknete Bejta.



Përfaqësuesit e pozitës, të opozitës dhe analistët politikë e kanë komentuar në mënyra të ndryshme 'kërcënimin' e Listës Serbe për rrëzimin e Qeverisë së Kosovës

# Maliqi: Dalja e Listës Serbe në opozitë paraqet sfidë serioze për Qeverinë

Njohësi i proceseve politike në vend, Shkëlzen Maliqi, ka vlerësuar se dalja e Listës Serbe në opozitë paraqet sfidë serioze për Qeverinë e Kosovës. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se tani Lista Serbe mund t'ia sigurojë numrat opozitës për ta rrëzuar Hardinajn. Por, Maliqi ka theksuar se ende nuk dihet nëse kjo lidhet me pakënaqësinë e Listës Serbe për taksën ndaj produkteve serbe apo është instrument që i shërben Beogradit për thellimin e përçarjeve në mes të partive shqiptare në fazën më delikate të finales së dialogut. Sidoqoftë, ai ka thënë se partitë opozitare nuk mund të jenë komode në pranimin e kësaj oferte

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Dalja e Listës Serbe në opozitë dhe 'kërcënimi' i saj për ta votuar mocionin për rrëzimin e Qeverisë së Kosovës është komentuar të dielën në mënyrë të ndryshme nga analistët politikë, përfaqësuesit e pozitës dhe të opozitës. Ndonëse Lëvizja Vetëvendosje e ka bërë të qartë se nuk dëshiron rrëzimin e qeverisë me votat e Listës Serbe, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Social Demokratike ende nuk kanë dalë me një qëndrim lidhur me këtë çështje.

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë për gazetën "Epoka e re" se dalja e Listës Serbe në opozitë paraqet sfidë serioze për Qeverinë Haradinaj sepse, sipas tij, ajo kërcënon se do të votojë çdo mocion kundër Qeverisë. Sipas Maliqit, ende nuk dihet nëse kjo lidhet vetëm me pakënaqësinë e Listës Serbe për taksën ndaj produkteve serbe apo është instrument që i shërben Beogradit për thellimin e përçarjeve në mes të partive shqiptare në fazën më delikate të finales së dialogut. "Dalja e Listës Serbe në opozitë paraqet sfidë serioze për Qeverinë Haradinaj, sepse ajo kërcënon se do të votojë çdo mocion kundër Qeverisë, duke ia siguruar kështu numrat që i mungonin opozitës për ta rrëzuar Hardinajn. Mirëpo, kjo 'ofertë' gjeneroze, ndonëse e përshëndetur nga Lëvizja Vetëvendosje, mund të jetë edhe 'e helmuar'. Nuk është e qartë nëse kërcënimi lidhet vetëm me pakënaqësinë e Listës Serbe me taksën për produktet serbe. Mund të jetë se kjo i shërben Beogradit si instrument për thellimin e përçarjeve mes partive shqiptare në fazën më delikate të finales së dialogut", ka theksuar ai, duke shtuar se opozita nuk mund të jetë krejtësisht komode për pranimin e ofertës së Listës Serbe. Sidoqoftë, Maliqi ka deklaruar se mbetet të shihet në ditët e ardhshme se si do të reagojnë të gjithë subjektet relevante, para së gjithash, LDK-ja dhe PSD-ja. "Partitë e opozitës nuk mund të janë krejtësisht komode për pranimin e kësaj 'oferte'! Nga ana tjetër, presidenti Thaçi ka paralajmëruar kundërmasën, nëse kalon mocioni, e rekonstruimit të Qeverisë me një koalicion tjetër, me Haradinajn ose edhe pa të, në mënyrë që të evitohen zgjedhjet e parakohshme që do të mund të bëhen pengesë për realizimin e marrëveshjes historike me Serbinë, siç është projektuar nga BE-ja dhe ShBA-ja, deri në pranverë. Mbetet të shihet në ditët e ardhshme se si do të reagojnë të gjithë subjektet relevante, para së gjithash LDK-ja dhe PSD-ja, duke i analizuar të gjitha pasojat e mundshme të zhvillimeve që rrjedhin nga ky kërcënim i Listës Serbe, përkatësisht Beogradi", është shprehur Maliqi.

Kurse zyrtarët e koalicionit qeveritar nuk i shohin të rrezikshme veprimet e Listës Serbe. Shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë të dielën për gazetën "Epoka e re" se teket e Listës Serbe nuk e përcaktojnë as të tashmen e as të ardhmen e Qeverisë së Kosovës, aq më pak të shtetit të Kosovës. Sipas tij, vendimet e institucioneve të Republikës së Kosovës nuk do të kushtëzohen nga shantazhet e tyre. "Teket e Listës Serbe nuk e përcaktojnë as të tashmen e as të ardhmen e Qeverisë së Kosovës, aq më pak të shtetit të Kosovës. Vendimet e institucioneve të Republikës së Kosovës nuk do të kushtëzohen nga shantazhet e tyre", ka deklaruar Krasniqi.

Pavarësisht prej paralajmërimit të Listës Serbe për rrëzimin e Qeverisë, partitë opozitare nuk kanë shprehur gatishmëri për të bashkëpunuar me Listën në këtë drejtim. Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, ka bërë me dije të dielën se kjo parti nuk do të bashkëpunojë me Listën Serbe për ta rrëzuar Qeverinë Haradinaj. Ai ka vlerësuar se Qeveria Haradinaj duhet të rrezohet sa më shpejt, por jo nga Lista Serbe për shkak të taksës ndaj mallrave serbe. "Ashtu siç ju patëm paralajmëruar para një viti në seancën e Kuvendit të Kosovës, erdhi dita që një nga partnerët e koalicionit qeverisës, Lista Serbe, po e kërkon rrëzimin e Qeverisë Haradinaj. Por, ashtu siç nuk jemi bërë bashkë me Listën Serbe, as për ta votuar Haradinajn, po ashtu edhe nuk bashkëpunojmë me Listën Serbe as për ta rrëzuar atë. Qeveria Haradinaj vërtet duhet të rrëzohet, sa më shpejt aq më mirë, por jo nga Lista Serbe për shkak të taksës ndaj mallrave serbe, por nga qytetarët e Kosovës dhe pozita për shkak se Qeveria Haradinaj është qeveri e paaftë, e skandaleve e, para së gjithash, një qeveri e padrejtë", ka shkruar Selimi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Social Demokratike (PSD) ende nuk kanë dalë me një qëndrim lidhur me këtë çështje. Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se deklaratat e Listës Serbe mund të jenë për konsum ditor dhe për t'i bërë presion Qeverisë për heqjen e taksës së vendosur ndaj produkteve të Serbisë. Ai ka theksuar se LDK-ja ende nuk ka qëndrim për pozicionin e ri të deputetëve serbë. Haziri ka thënë se votat e Listës Serbe kanë qenë vendimtare për formimin e Qeverisë dhe të njëjtat mund të shërbejnë edhe për rrëzimin e saj. "Ne ende nuk kemi marrë qëndrim sa iu përket zhvillimeve. Gjithçka që është në funksion të stabilitetit të vendit do të shqyrtohet seriozisht. LDK-ja nuk e ka diskutuar. Jemi duke e përcjell me kujdes të veçantë dhe me kohë do ta vlerësojmë", ka thënë Haziri.



# Rriten gjobat për ata që u shesin alkool e duhan personave nën 18 vjeç

**Prishtinë, 11 nëntor** - Të rinjtë nën moshën 18-vjeçare, deri së voni, kanë mundur t'i blejnë të gjitha produktet, përfshirë edhe alkoolin dhe duhanin. Fëmijët apo adoleshentët i kanë blerë këto produkte nëpër dyqane, ndërkaq nuk ka munguar as dukuria e konsumimit të tyre nëpër kafeteri apo restorante.

Ndonëse Ligji për mbrojtjen e konsumatorit ekziston dhe ka paraparë ndalesën për shitjen e produkteve të duhanit dhe alkoolit nën moshën 18-vjeçare, kjo nuk është respektuar. Së fundmi, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka marrë vendim që neni 15 i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit të zbatohet me përpikëri. Në të kundërtën, ka paralajmëruar dënime nëse këto produkte u shiten të rinjve nën moshën 18-vjeçare. Gjobat me ligj për shitësit sillen nga një mijë deri në dhjetë mijë euro.

Sociologët e konsiderojnë shtrëngimin e masave për shitjen e produkteve të ndaluara për të rinjtë deri në moshën 18-vjeçare si të domosdoshme, duke tërhequr vërejtjen se kontaktet e fëmijëve apo të rinjve me këto produkte i kanë efektet e veta negative.

Leutrim Sahiti, sociolog, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se një vendim i tillë është i mirëseardhur, duke potencuar faktin se, sidomos dyqanet (marketet) rreth shkollave, që kanë lejuar blerjen e produkteve të ndaluara nga të rinjtë, kanë sjellë telashe. "Ky është një hap pozitiv për krijimin e një shoqërie dhe vetëdijesimin e të rinjve karshi dukurive negative. Sigurisht se qasja deri më tani për blerjen e duhanit dhe alkoolit nga të rinjtë e moshës nën 18-vjeçare ka ndikuar negativisht në shfaqjen e shumë dukurive dhe sjelljeve devijuese te të rinjtë. Kjo ka ndikuar edhe në rritjen e numrit të të rinjve që konsumojnë duhan dhe alkool", ka thënë Sahiti, duke shtuar se konsumimi i alkoolit ka sjellë edhe konflikte në mes të rinjve. "Ajo që ka qenë shqetësuese dhe vlen të përmendet është edhe fakti se afër shkollave ka markete të mëdha ku janë shitur cigare dhe alkool", është shprehur Sahiti.

Ndërsa në Klinikën Neuropsikiatrike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Shaban Mecianaj, neuropsikiatër, ka bërë me dije se në këtë klinikë më shumë pranojnë raste të fëmijëve që abuzojnë me substanca narkotike, derisa thotë se rastet e të rinjve të varur nga alkooli janë të rralla. "Ne nuk kemi pasur pacientë që i takojnë kësaj grupmoshe që kanë kërkuar trajtim nga alkooli. Ndërkaq nga substancat narkotike kemi raste, kryesisht nga konsumimi i marijuanës, që kërkojnë ndihmë e që kanë shfaqur shenja të çrregullimit psikotik akut. Ka ndodhur edhe që i kemi hospitalizuar këto raste. Por, nuk kemi raste të varësisë me alkool të kësaj grupmoshe, pra nën 18 vjeç", ka thënë Mecinaj.

Vendosja e masave shtrënguese, megjithatë, vlerësohet se sjell efektet e veta vetëm nëse arrin të zbatohet në praktikë. Disa të rinj të intervistuar thonë se pa ndonjë problem ata mund të hyjnë nëpër vendet e ndaluara për ta, si diskotekat, ku edhe mund të konsumojnë alkool apo duhan, pavarësisht se aty qëndrojnë shenjat '18+', që ua ndalojnë atyre hyrjen.

Kështu thotë Mentori (identiteti i njohur për redaksinë), një i ri 17-vjeçar i cili vijon mësimet në njërën prej shkollave të mesme në Prishtinë. "Nuk ka asnjë lokal nate apo edhe diskotekë në Prishtinë që ndalon hyrjen e të rinjve nën moshën 18-vjeçare. Unë si 17-vjeçar dal në mbrëmje me shokë, kryesisht fundjavave dhe na lejohet të hyjmë, sepse besoj ata përfitojnë nga ne. Aty lejohet të konsumosh çka të duash. Te ne ligjet nuk zbatohen", ka thënë ai.

Por, a do të vazhdojë gjendja e njëjtë edhe pas vendimit të fundit të Qeverisë, mbetet të shihet. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se është i vendosur për zbatimin e nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit. "Në mungesë të implementimit në tërësi të këtij ligji, i cili e përcakton që pijet alkoolike dhe duhani janë të ndaluara të shiten dhe shërbehen për moshën nën 18-vjeç, kam marrë vendim që ta urdhëroj inspektoratin që të zbatojë në përpikëri nenin e ligjit", ka deklaruar ministri Shala.

Organizatat joqeveritare që merren me trajtimin e përdoruesve të substancave narkotike thonë se kohët e fundit vërehet rritje e konsumimit të duhanit, alkoolit dhe substancave narkotike. Ekspertët thonë se përdorimi i alkoolit dhe substancave narkotike nga të rinjtë mund të shkaktojë dëme të rënda në zhvillimin e tyre fizik, mendor dhe moral.



# Rriten shpenzimet për paga dhe mëditje për 26 milionë euro

Në projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 është paraparë të rriten shpenzimet për paga dhe mëditje në vlerë prej 26 milionë eurosh krahasuar me vitin 2018. Avazi i rritjes së pagave dhe mëditjeve, sipas këtij projektligji, do të vazhdojë deri në vitin 2021, në diferencë prej miliona eurosh. Lidhur për këtë çështje kanë folur Agim Shahini, Shaqir Palushi dhe Lulzim Syla



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Në projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, i cili ka kaluar në Qeverinë e Kosovës dhe pritet të votohet në parim në Kuvendin e Kosovës, janë rritur shpenzimet për paga dhe mëditje në vlerë prej 26 milionë eurosh. Avazi i rritjes së pagave dhe mëditjeve, sipas këtij projektligji, do të vazhdojë deri në vitin 2021, në diferencë prej miliona eurosh. "Në vitin 2018 buxheti për paga dhe mëditje ishte 590 milionë euro, kurse në vitin 2019 parashihet që shpenzimet për paga dhe mëditje të jenë 616 milionë euro, në vitin 2020 parashihen shpenzime 649 milionë euro, ndërkaq në vitin 2021 janë paraparë 670 milionë euro shpenzime", theksohet në projektbuxhetin e vitit 2019.

Ndërkaq si pjesëmarrje e Bruto Produktit Vendor (BPV) kjo kategori e shpenzimeve në buxhetin e planifikuar për vitin 2019 paraqitet me trend pozitiv nga 8.8 për qind të buxhetit. "Shpenzimet për paga dhe mëditje vazhdojnë të mbajnë një pjesëmarrje të konsiderueshme në shpenzimet e përgjithshme. Për dallim prej viteve paraprake, në veçanti nga viti 2018, në propozimbuxhetin e këtij viti rritja e këtyre shpenzimeve vjen si rezultat i vazhdimësisë të implementimit të kontratës kolektive. Shpenzimet për kategorinë paga dhe mëditje për vitin 2019 janë paraparë të jenë 616 milionë euro, një rritje prej 4.4 përqindësh në raport me shpenzimet e parashikuara për paga dhe mëditje me buxhetin për vitin 2018. Në anën tjetër, si pjesëmarrje e BPV-së kjo kategori e shpenzimeve në buxhetin e planifikuar për vitin 2019 paraqitet me trend pozitiv nga 8.8 për qind të buxhetit për vitin 2018, në 8.6 për qind në vitin 2019, për të vazhduar një pjesëmarrje të ngjashme deri në vitin 2021. Shpenzimet për paga dhe mëditje si pjesëmarrje në BPV parashihen të mbesin përafërsisht të njëjta edhe në vitet vijuese (në 8.6 për qind dhe 8.4 për qind për vitin 2020 dhe 2021)", thuhet në projektbuxhetin e vitit 2019.

Lidhur me këtë kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB) ka thënë për gazetën "Epoka e re" se kjo rritje e pagave dhe mëditjeve është e paarsyeshme dhe në vend të kësaj, sipas tij, shteti do të duhej të mendonte për avancimin e sektorit privat dhe rritjen ekonomike. "Buxheti i vitit 2019 është më i madhi në historinë e vet. Kjo neve na gëzon shumë se Kosova po realizon rritje. Duke analizuar buxhetin e shpërndarë dhe të formës se nga do të shpenzohen këto mjete, neve na shqetëson fakti se buxheti nuk është i orientuar kah sektori privat, por kah skemat sociale që të mos promovojë zhvillim ekonomik, duke u dedikuar për rritje të pagave dhe të mëditjeve", ka thënë Shahini, duke shtuar se pagat dhe mëditjet duhet të rriten, por që kjo do të duhej të bëhej konform rritjes ekonomike. Ai ka theksuar se rritja e pagave në sektorin publik shkakton hendek në mes të punëtorëve të sektorit privat. "Pagat dhe mëditjet në sektorin publik rriten në saje të pagesave që bëjnë ata të sektorit privat, pra punëtorët dhe bizneset paguajnë taksa dhe tatime, në anën tjetër pagat u rritën atyre të sektorit publik. Kjo shkakton hendek në mes të dy sektorëve", ka thënë Shahini.

Table 2. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive ekonomike, 2016-2021

| Përshkrimi | 2016 | 2017 | 2018 Buxheti | 2019 Proj. | 2020 Proj. | 2021 Proj. |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2. SHPENZIMET TOTALE** | **1,658** | **1,741** | **2,104** | **2,365** | **2,426** | **2,487** |
| **2.1 SHPENZIMET RRJEDHËSE** | **1,221** | **1,282** | **1,386** | **1,567** | **1,584** | **1,624** |
| Pagat dhe mëditjet | 544 | 550 | 590 | 616 | 649 | 670 |
| Mallrat dhe shërbimet | 203 | 226 | 265 | 337 | 317 | 334 |
| Subvencionet dhe transferet | 475 | 506 | 526 | 609 | 614 | 615 |
| Rezerva | 0 | 0 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| **2.2 SHPENZIMET KAPITALE** | **444** | **468** | **694** | **770** | **813** | **835** |
| *prej tyre me financimi nga:* Buxheti i rregullt | *444* | *468* | *546* | *509* | *533* | *648* |
| Klauzola e investimeve | *0* | *0* | *62* | *121* | *220* | *187* |
| Fondet e likuidimit (AKP) | *0* | *0* | *86* | *140* | *60* | *0* |
| **2.3 Kredidhënia Neto** | **-7** | **-9** | **0** | **0** | **0** | **0** |

Edhe prodhuesi vendor, Shaqir Palushi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se Qeveria e Kosovës në vend të rritjes së pagave dhe mëditjeve për zyrtarët shtetërorë, do të duhej ta kishte në fokus përforcimin e prodhuesve vendorë pasi do të gjeneroheshin më pas vende të reja të punës. "Fokusi i Qeverisë së Kosovës do të duhej të ishte te mbështetja e kompanive prodhuese pasi që dihet se biznesi privat mund të gjenerojë vende të reja të punës. Nëse Qeveria do të aplikonte më shumë subvencionime, grante dhe lirime të tjera për prodhuesit vendorë, atëherë do të ndikonte në gjenerimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike, duke ndikuar kështu në rritjen e eksporteve", ka deklaruar Palushi. Sipas tij, me këto miliona euro që Qeveria e Kosovës i ka parë për rritje të pagave dhe për mëditje, do të ishte më mirë t'i mbështesnin bizneset vendore. "Me këtë politikë po dekurajohen prodhuesit vendorë dhe punëtorët e sektorit privat pasi që kërkesa për t'u punësuar në sektorin privat është në rënie dhe llogariteni kur krejt kësaj ia shtojmë edhe diferencën e pagave në mes të sektorit privat dhe publik", është shprehur Palushi.

Edhe njohësi i çështjeve ekonomike, Lulzim Syla, ka thënë se me rritjen e pagave dhe të mëditjeve Qeveria e Kosovës është duke tentuar ta blejë paqen dhe të arsyetohet para elektoratit. "Ministria e Financave, respektivisht Qeveria e Kosovës, këtë rritje të pagave e ka bërë shkaku i paqes sociale, por edhe për shkak të paralajmërimeve të protestave apo problemeve të mundshme që do t'i shkaktojnë sindikatat. Është e mirëseardhur kur shteti u ofron kushte më të mira qytetarëve dhe rritje të pagave, por problemi është që duhet të bëhet një balancë në mes të sektorit privat dhe publik. Kur të shpërndahen në baza proporcionale, rritja e pagave nuk është shumë domethënëse. Praktikisht po dalë në rolin e mësuesit dhe mjekut, por s'duhet të ketë hendek në mes të dy sektorëve", u shpreh Syla. Ndërkaq sa iu përket mëditjeve, ai ka theksuar se assesi nuk do të duhej të kishte rritje dhe dhënie të mëditjeve. "Jam kundër dhënies së mëditjeve dhe rritjes së tyre pasi mëditjet karakterizohen për diçka që është në kuadër të punës dhe nuk përkojnë me kushtet ekonomike në Kosovë dhe deputetët nuk duhet ta kenë komoditetin e shpenzimeve enorme, pra për të shpenzuar mjete që nuk kanë mbulesë, pasi janë në kuadër të punës dhe pagës. Mendoj se duhet të bëhet një analizë krahasuese me pagat e sektorit privat, pasi pagat në sektorin publik janë të mbivlerësuara", ka thënë Syla për gazetën "Epoka e re".

# Në Gjilan ndalohet i mituri për substanca narkotike

**Gjilan, 11 nëntor (ER)** - Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për të Mitur, ka ndaluar të miturin A. E. në kohëzgjatje prej 24 orësh. Ekziston dyshimi i bazuar, se të shtunën, në një shkollë të mesme në Komunën e Vitisë, tek i mituri A. E., gjatë kontrollimit nga policia, janë gjetur 7.7 gramë substancë narkotike e llojit "marijuanë'", të cilën i njëjti e kishte siguruar në mënyrë të paautorizuar.
Prokuroria menjëherë pasi është njoftuar me rastin ndaj të miturit ka nxjerrë aktvendim mbi ndalim për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale "Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge" nga neni 275, paragrafi 1, lidhur me nenin 281, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Po ashtu, prokuroria ka ushtruar kërkesën për caktimin e paraburgimit, në gjykatën kompetente në Gjilan, duke pasur parasysh faktin se i njëjti ka poseduar substancë narkotike në objekt të shkollës, si dhe ekziston mundësia e rrezikut të ikjes, pasi ndaj tij udhëhiqet procedurë penale edhe për vepra të tjera penale.





# Ahmeti kërkon nga këmbësorët dhe vozitësit t'i respektojnë shenjat e komunikacionit

**Prishtinë, 11 nëntor (ER)** - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se te Qendra e Studentëve ka vendosur grilat ndaluese në mënyrë që këmbësorët të kalojnë në vendet e dedikuara për ta. Në këtë kontekst, Ahmeti ka kërkuar nga këmbësorët dhe vozitësit t'i respektojnë shenjat e komunikacionit. "Edhe këmbësorët edhe vozitësit duhet t'i respektojnë rregullat dhe shenjat e komunikacionit. Në udhëkryqin pranë Qendrës së Studentëve shpesh janë shkaktuar aksidente si pasojë e kalimit të rrugës në vend të gabuar. Tani kemi vendosur grilat ndaluese, ashtu që këmbësorët ta kalojnë rrugën vetëm në vendkalimet e dedikuara për ta", ka shkruar Ahmeti në llogarinë e vet në "Facebook".

# Mbyllen gjashtë bastore në Ferizaj

**Ferizaj, 11 nëntor (ER)** - Një aksion i ndërmarrë këtë fundjavë nga Inspektorati Komunal, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Stacioni Policor në Ferizaj, me përbërje edhe nga inspektorët e tregut, sanitarë dhe zyrtarë nga Drejtoria e Financave, ka rezultuar me mbylljen e gjashtë pikave të basteve brenda qendrës së qytetit, biznese këto që operonin pa kushtet e nevojshme sanitare, pa dokumentacion biznesor dhe në kundërshtim me kërkesat ligjore të ligjeve në fuqi që rregullojnë këtë fushë. "Shumica prej tyre nuk kanë fare as certifikatën biznesore dhe as kushtet minimale-teknike për zhvillimin e veprimtarisë", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.
Sipas kësaj komune, mbyllja e këtyre lokale është procesuar me hapjen e procedurës pranë organeve të drejtësisë dhe, si i tillë, ky aksion disamujor ka ulur numrin e bizneseve të tilla që kanë operuar në Ferizaj.




Ridvan Berisha, koordinator i Inspektoratit Komunal, ka thënë se janë të vendosur bashkë me kryetarin e Ferizajt, Agim Aliu, për zero tolerancë ndaj bizneseve të tilla që çdo ditë favorizojnë informalitetin fiskal dhe rrezikojnë mirëqenien e qytetarëve.
Ferizaj është komunë kampione në rang kombëtar për kontrollin e zhvillimit të kësaj veprimtarie. Deri më tani Inspektorati Komunal ka mbyllur mbi 20 pika bastesh dhe kazinosh, duke arritur që edhe të arkëtojë nga borxhet e tyre ndaj komunës mbi 500 000 euro, fonde që do të përdoren për investime në dobi të shëndetit publik e mirëqenies qytetare.

# Nis renovimi i bazamentit të shtatores së Edmond Hoxhës

**Junik, 11 nëntor (ER)** - Komuna e Junikut ka bërë me dije se kanë filluar punimet për renovimin e bazamentit të shtatores së heroit kombëtar Edmond Hoxha. "Filluan punimet për renovimin e bazamentit të shtatores së heroit tonë kombëtar Edmond Hoxhës", ka njoftuar Komuna e Junikut. Edmond Hoxha ka lindur më 10 tetor të vitit 1975 dhe ka rënë heroikisht në Pestovë të Vushtrrisë më 31 janar të vitit 1997. Ai ishte një nga luftëtarët e parë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).



(Procesi gjyqësor i Prizrenit më 1946 sipas dokumenteve të gjykatave ish-jugosllave. Para trupit gjykues dolën 34 patriotë të cilëve gjyqi ua shqiptoi dënimet: gjashtë veta i dënoi me pushkatim, të tjerët me vite të shumta burg) /19/

# Ballafaqimi që iu bë të pandehurve Tahir dhe Rexhep Avdullahut



Prof. dr. Sabile
KEÇMEZI-BASHA

*(Sqarim: Shkrimi në vazhdim botohet pa i bërë redakturë gjuhësore pasi është i shkruar si në dokumentet origjinale)*

I pandehuri Basri si u pyet tha se: kur mar instruksionet mua mi ka dhene Hasani i cili ma se pari me ka kerkue listat, e Hasani personalisht mi ka dhanë.
Kur u pyet mbi ndryshimin thase kam qene i habitur e këtë të gjitha Hasani mi ka dhene, e me ka thënë se Halimi mi ka que keto fjalë, por mundet qe ai rren me që Halimi sme ka thënë vet gjë. Unë i bazuar ne fjalet e Hasanit, kam thënë për Halimin. Unë i kam bame keto me fjalet e Halimit e jo me fjalet e Hasanit, unë me Halimin skam kur fare lidhje, por vetem jam njoftun me te. Pse kemi biseduar per punë politike, e kur Hasani me qonë fjalë tue me thanë se me cje Halimi kam punue, pse Hasani asht njeri i tij. Këto punë i kam ba pse kam qenë i marr e kam bame per hatër të Halimit e per me formue nji organizatë. Në vjetin 1944, unë me Hasanin kemi qenë në Mitrovicë ne burg, dhe atje në gjyqë na kanë kallxue se jemi të lirë atje na kanë pyetur politikisht koftra gjermanëve, e se dyti une jam burgos prap por jo ne burg por me kanë mbajtur nen vrejtje. Hasani me ka thanë se ka ardhë në Prizren me uniformë gjermane per me u pa me familjen e vet. Shkaku i veshjes se Hasanit me tesha asht si me tha ai, e une Hasanit ne mbrëmje i kam thanë perse u veshe me ato tesha, por ai më është përgjigjur hajde more. Kur me kanë lirue ka shkue e ka thene se neve kemi qene ne burg e kemi marr pa fajsi dhe ne kete menyë me kanë lirue. Hasani ska qenë në sherbim të gjermanve, unë Haasanin e kam dijt njeri të lëvizjes.
Hasani dy herë ka ardhë dhe me ka pru instruksione e me ka thanë se ne Shqipëni do të bahet nji qeveri ma e gjanë dhe me ka thanë Hasani se Halim i ka thanë per mua qe me ndejt atje se ne Shqipni do të bahet nji ndryshim, e heren e dytë me ka thanë se don listat për të vramit e Kosovës e Metohisë.
Ballafaqimi qe iu ba të pandehurve Tahir dhe Rexhep Avdullahut, Rexhepi tha: Tahiri me ka dhene nj letër per Ymer Berishën qe e çonte Nebi Sejdiu, kete te fundit nuk e di a eshte ne mal ose jo.
Kur u pyet i pandehuri Tahir tha se une me Ymer Berishën nuk jam njohtun, te cilit i kam shkrue nji beterë me pak fjalë e ky Rexhepi e ka que, dhe Ymeri ka qenë vertet ne mal. Çka i kam shkrue nuk e dij.
I pandehuri Rexhep tha se, Ymeri i shkruante Tahirit se Radio Stanicë nuk kemi e ushqim e ndihma skemi se ballonat nuk po na lshojn, skemi lidhje me kerkend e kërkonte radiostanicë. Tahiri mua më ka thënë se po behen padrejtësi në Kosovë.
Kur u pyet i pandehuri Tahir, mohoi qe ti ketë thënë gjë të pandehurit Rexhep.
I pandehuri Rexhep tha se une vetem nji herë kam que leter ne Drenicë dhe Tahiri me ka thanë se kemi lidhje me Shqipni e Drenica me tjera shtete.
Kur u pyet i pandehuri Tahir i cili tha se nuk janë te drejtë çka thotë i pandehuri dhe ju kthye te pandehurit Rexhep dhe i tha mos me merr në qafë. Mohon dhe sa ka thënë ne proces se ne Rahovec, Ferizaj e tjera do bajn mësymje ballistat e malit e se une kam que fjalë me i ndal. Me Ymer Berishën kam dasht me zanë lidhjen, kur u pyet më parë se tha se kamgabue.. Unë Ymer Berishës i kam shkrue, tue kërkue e pyet ate per Ismail Goranin dhe Rexhepi ma ka dhane emnin e tij dhe thuesh se ajo letër asht shkrue kot. Basri Sallkos i kamthanë me të vertet me formue Komitet në Ferizaj ashtu dhe në Prishtinë e Podujevë. Mua udhëzimet mi ka dhanë Hasan Rema n'emën të Halim Spahisë, shpresën e kam pas per me marre instruksione e të tjera me keto shokët e mij, se Hasani vetem me ka kerkue listat, tue me thanë se i donë Halimi.
Kryetari i gjyqit urdhëron te bahen dhjet minuta pushim. Mbas kalimit te kësaj kohe, trupi gjykues tu qenë i formuem si më parë u kthye në sallën e gjykimeve dhe kështi filloi gjyqi botërisht.
Si u pyet prap i pandehuri Tahir tha se: Hoxhë Maliqi vetem njihere ka shkue në Rahovec dhe ka shkue me nj letër dhe ka prue vetem shenimet e letër prej meje tjetër herë nuk ka pru.
Unë dhe Fehim Ibrahimi kemi bisedue per tre veta me i marr e hoxha ska pas lidhje me ne e vetem se paska shkue në Rahovec per me formue Komitetin me dy tre veta emër si kemi dhënë tue kërkue m'andej si te formohet me na dhanë listat e te vrave. Unë vetem njihere e kam que, e për t'u bisedue kam fjalosur dy herë, bisedimi ka qenë politikisht, si nuk me ka pyet se perse ato shënime. Bisedimi me te ka qenë ne çështje nacionale dhe i kam tregue se kemi lidhje. Unë hoxhës se i kam tregue qe kemi lidhje me njerëz, hoxhës nuk i kam thanë qe shko te Kadri Minushi se unë ate nuk e njomi se une ate nuk e njomi. Unë hoxhës i kam thanë vetem ne pikëpamje te votimeve se kanë me u ba.
Kur u pyet i pandehuri Hoxhë Maliqi thase, Kadri Minushi me ka qu ke Tahiri e ke Kajtazi, por une si i thash qe nuk e njomi nuk kam treguar Kadriut dhe i kam thanë perme formuar komitetin e me mbledh hetimet.
I pandehuri Tahir thase: Unë Kadrin nuk e njomi dhe çka thotë ai nuk është e vërtet dhe se e kam drejtue ke Kadrija. Unë dhe njihere tjetër e kam dergje ne Rahovec hoxhen.
I pandehuri Hoxhë Maliqi, thase ky dyerë me ka que njihere me fjale dhe njihere me letër np Rahovec, të cilat letra... shqye, përse çka përmbante ajo letër nuk e di.
I pandehuri Tahir tha se, unë ke Kadriu kete nuk e kam drejtue.
I pandehuri Hoxhë Maliqi tha se, nuk është e vërtet qe une kur kam pame nji person me shenjë kryet e Titos e t'i kam thene se ku do të humbi. Për shenimet Tahiri me ka thanë se me duhen mua e vetëm nji herë me ka thanë se ka njoftoje me nji Prokuror ne Kukës, por nuk me ka thanë se ku i qonë. I pandehuri shtoj e tha se unë për gjyqëtarin para OZN-es e kam ndegjue kur ka thanë ky vet, nuk e kam pyet se a ka lidhje me te apo jo. Ky Tahiri me ka thanë neve duam të mbrojm Kosovën dhe Titon nuk e duam, e neve me e mbrojt duhet ushtar me shkue.
Kur e pyeti i pandehuri Hasan Hysenin, për Sali Kolgecin kam pyet Tahirin se përse po e burgosin, ky me ka thanë se per vrasjen e Milladin Popoviqit në Prishtinë.
Kur e pyet i pandehuri Tahir mohoi krejtësisht.
I pandehuri Hasan tha se, me datë 25/26 maj jam takue me Tahirin i cili ishte i deshpruar dhe me kallxoi se kishte marre rrogën, tue më thanë ja keta dinar kam marr e çka me ba me to, e prap me tha i kam tre veta per me i nxjerr jashtë, per ate qe i ka qit jashtë a po jo nuk e di.
I pandehuri Tahir mohoi deklaratën e të pandehurit Hasan dhe pohoi se për ato dy vetat i kam thanë por ata kan shkue vetë në mal e jo me anë time.
Për vrasjen e Milladin Popoviqit nuk kam dijeni fare per kete vrasja e tij as më ka idhnue as nuk me ka gëzua. Rexhep Kabashi, Halim Spahija, Hasan RRustemi e tp tjerë i njomi. Me Fehim Ibrahimin skemi pas lidhje. Për vrasjen e Milladinit, neve skemi pas aspak dijeni.
Kur u pyet i pandehuri Kadri Minushi tha se: Tahir Dedën une kur do njihere nuk e kam oamun, por para burgimit e kam pamun ne Obllasni Odbor dy javë përpara kur kam que do pare.
Kur u pyet i pandehuri Tahir tha se, unë nuk e njomi kete fare. I pandehuri Kadri thase: une une kam pas que do pare ne Obllast për me i dhanë, e ky Tahiri me ka thanë se paret i mer Kola dhe jo une, dhe kur e kam pyetur me ka thanë se ishte Tahiri atje por me te skemi folë gjë. Hoxhë Maliqi me ka thanë na vyen do lista per te vramit se mi lypë Tahir Deda e Spahija, e perse nuk e dinte. Unë skam dijt gjë por ky me thonte se Deda e Spahija janë njerëz nëpunës, e për komitet nuk me ka thënë gjë.
I pandehuri Hoxhë Maliqi thase, unë i kam thanë se te formohet komiteti e me kerkue listat, e une ta dij per kete si kishe me kanë.
I pandehuri Kadri Minushi thase, ky hoxha te ka vue në lidhje me Tahirin, e nuk me ka thanë me bamun komitet dhe kete dhe kete e kam pasun të njoftun fare mirë.
I pandehuri Hoxhë Maliqi thase ky e ka pranue fajin se ka punue.
I pandehuri Kadri MInushi thase kur vinin këtu përpara gjyqit te lidhur per krahi une me Hoxhen ky me ka thanë se une kam thanë per komitet e ti pranoj si dhe perse ka thanë Ismail Gashi per vrasjen e Nikolla Vidaqiqit, se ka dasht me vra Ahmet Derguti, keto fjalë mi ka thanë në rrugë nga burgu ketu.
I pandehuri Hoxhë Maliqi thotë se Ahmet Dërguti ka thanë qe mos thoni për tentativën e vrasjes.
I pandehuri Kadri tha se, unë nuk i kam thanë gjë këtij për komitet e as ky me ka thanë se ka komitet në Prizren. Hoxha kur me ka lypur listen me ka thanë se i donë Tahiri e Spahija, unë kam que fjalë me Ahmet Dërgutin. Ahmeti thse une i di ato mi ka dhanë Ahmeti letrën e une kam gjet njeri i cili ja ka que letrën, por a e ka marre ai atë letër ose jo nuk e di.
I pandehuri Hoxhë Maliqi tha se: Kur kam qene atje me shtepi, Minushi me ka kallxue emnat e komitetit edhe ka përmend veten, Shehun e Ahmet Dërgutin, ky me ka kallxue se Ahmetit i është vrar nji vëlla dhe Vidaqiqin ka dashte me e vramun, per kete e kanë ndalue masi ishim ne komitet, se nuk duhet me vramun njeri e skemi qëllim vrasje, këte kështu ma ka thanë vete me goje Kadri Minushi. Mua Tahiri me ka thanë se ai donte shtinet por jo për Halimin Spahin se dhe këtij Minushit, si kam thanë gjë për Halimin.
I pandehuri Kadri Minushi thase, me ka thanë per Halim Spahin. Unë ke Tahiri ne zyre kam shkue mbasi ka ardhur Hoxha e qe i kishe que listen, e me Tahirin s'kam folë fare sepse nuk e njohi.
I pandehuri Tahir thase ketu shifet mirë se keta janë takue njeri me tjetrin ne burg dhe i kanë rregullue fjalet e me ngarkojn mua.
Kur u pyet i pandehuri Hoxhë Maliqi, thase unë kam qenë gjithnjë i kënaqur per kete punët e partizanve.
Mbi kërkimin e prokurorisë u muer si dëshmitar Ismail Gashi i cili ndodhet në sallen e gjyqit.
Dëshmitari: Ismail Gashi, 33 vjeç, nga Rahoveci, te pandehurit disa i njef me te indiferent i cili mbasi u betua rregullisht kur u pyet thase: Kur ka ardhur ketu si i thirrun per ushtaret e vetem jam takue me hoxhë Maliqin, ku ishte edhe Kadri Minushi, e me ka thënë se, qe kete ne gjokës tue tregue nishanin qe kisha, unë i kam thanë se kjo eshte koka e Titos e do e mbaj si kujtim te tij. Ky me tha se pse e mban se ky ka me mbarue. Ke kazermat e Rahovecit, kam qenë po me Kadrin kurse Hoxha i ka thanë se dua listat e të vrarve te Rahovecit, ky hoxha për komitet e per vrasjen e Vidojes, i ran vet perme shpëtue nga faji e per me ngarkue te tjeret.
I pandehuri Hoxhë Maliqi thase, nuk e pranon deshmin e tij se nuk eshte e drejt, sa për listat ja kam kerkue Kadriut, e keto ja kam kerkue në shtepi kur ishte vetem Kadriu.
I pandehuri Tahir kur u pyet tha, veç kësaj qe thash lidhje tjetër me hoxhë Maliqin skam pas. Me Rafet Krasniqin njihem prandaj marrëdhënie me te skam e as nuk jam takue me te.
I pandehuri Kadri tha se unë hoxhës nuk i kam kallxue emnat e njerëzit e komitetit, e para thotë ky nuk e di se ashtu edhe ai sme ka dhënë emër tjetër.
Kur u pyet i pandehuri Hoxhë thase: Tahiri ardhe nji ditë ke dogaja ime dhe kemi bamun bisedime per te mbaramen herë e me ka thanë se, jam tue organizue nji organizatë e me duhen do njerëz e se ka marrëveshje me Ferizaj, Rahovec e Prishtinë e nga Kukësi me Halim Spahin e me larg sme ka thanë gjë. As gjë tjetër per shpejtesi e gjë tjetër, por vetem jam tue organizue e me duhen djelm të ndershëm.
I pandehuri Tahir kur u pyet thase vetem fjala inisiativ nuk është e vertet qe e kam marre unë e të tjerët janë të drejta e me kete kemi bisedue por ato njerëz e masi u arrestum mbeti puna pa u krye. I pandehuri Fehim Ibrahimi thase, i pandehuri Tahir me ka thënë se ka tre oficera e duan me i qit ne mal e lypte djelm e ma vonë me ka thanë se, ata kanë shkue në Gjakovë.
I pandehuri Tahir thase ata kanë shkue vetë në mal e jo me anën time e as me te Fehmiut.
I pandehuri Fehim tha se: Unë nuk kam shkue kurr me gjetë lidhje e me que ata ne mal, e as Tahiri ska ardhur me ne dogajen time.
Unë Tahirit i kam thanë se ketu në Prizren ka nji komitet dhe mua me kanë thirr, por une skam pranue me hi ne te e jo tjetër. ***(Vijon)***

## Fillon rinumërimi elektronik i votave në Florida



UASHINGTON, 11 NËNTOR - Autoritetet e shtetit të Floridës urdhëruan të shtunën rinumërimin elektronik të votave të zgjedhjeve kontestuese për senat dhe për guvernator, pas akuzave për mashtrim nga kandidatët.
Tetëmbëdhjetë vjet pasi Florida ishte në qendër të një beteje për presidencën amerikane, ky shtet përsëri tërhoqi vëmendjen e amerikanëve pas zgjedhjeve të së martës, të cilat ende nuk vendosën në mënyrë të qartë fituesin e garave për senator dhe guvernator të shtetit. Gjashtëdhjeteshtatë disktrikte të Floridës kishin afat deri të shtunën në mesditë për të dorëzuar rezultatin jozyrtar të zgjedhjeve.
Ligji i shtetit thotë se automatikisht duhet të ketë rinumërim elektronik të votave nëse dallimi mes kandidatëve është më i vogël se 0,5 për qind. Sekretari i shtetit në Florida, Ken Detzner, lëshoi urdhrin zyrtar për rinumërimin e votave pak kohë pas afatit përfundimtar të numërimit të votave.
Pas përfundimit të numërimit të votave, gara për senator mes guvernatorit republikan në largim, Rick Scott dhe demokratit Bill Nelson ishte shumë e ngushtë. Kandidati republikan Rick Scott ka një epërsi prej vetëm 12,562 votash nga gati 8.2 milionë vota të hedhura, një diferencë prej vetëm 0.15 për qind.
Në garën për guvernator të shtetit, rezultatet më të fundit jozyrtare në faqen e internetit të divizionit për zgjedhjet në Florida tregojnë se republikani Ron DeSantis, i cili u mbështet nga presidenti Donald Trump, ka një epërsi ndaj rivalit të tij demokrat Andrew Gillum prej vetëm 33,684 votash nga më shumë se 8.2 milionë të hedhura, ose një diferencë prej 0.41 për qind të totalit të votave. Në lidhje me të dy këto raste, në faqen e internetit të divizionit për zgjedhjet në Florida thuhet se është aktivizuar rinumërimi elektronik.
Kandidati demokrat për guvernator, Andrew Gillum, i cili të martën pranoi humbjen, ndryshoi qëndrimin e tij të shtunën, duke thënë: "Po zëvendësoj fjalët e mia të pranimit të humbjes me një thirrje të pakompromis për numërimin e çdo vote".
Në një deklaratë të publikuar të shtunën, sekretari i Shtetit i Floridës, Detzner, tha se rezultatet e rinumërimit elektronik duhet të publikohen më 15 nëntor në orën 15.00.

# Shënohet 100-vjetori i përfundimit të Luftës së Parë Botërore

Në këtë ceremoni, në të cilën morën pjesë rreth 70 liderë botërorë, ishin të pranishëm edhe presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ai rus, Vladimir Putin dhe kancelarja gjermane Angela Merkel, me ç'rast presidenti i Francës, Emmannuel Macron, mbajti një fjalim te Harku i Triumfit, ku është varrosur një ushtar i panjohur që është vrarë gjatë luftës




PARIS, 11 NËNTOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka mirëpritur rreth 70 liderë botërorë të dielën në Paris, të cilët kanë marrë pjesë në ceremoninë për ta shënuar 100-vjetorin e përfundimit të Luftës së Parë Botërore.
Armëpushimi hyri në fuqi më 11 nëntor 1918, duke i dhënë fund kështu luftës katërvjeçare, që la të vdekur të paktën 10 milionë ushtarë dhe miliona civilë. Macroni mbajti një fjalim te Harku i Triumfit, ku është varrosur një ushtar i panjohur që është vrarë gjatë luftës.
Në këtë ceremoni, në të cilën morën pjesë rreth 70 liderë botërorë, ishin të pranishëm edhe presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ai rus, Vladimir Putin dhe kancelarja gjermane Angela Merkel. Në fjalimin e tij, Macroni u bëri thirrje liderëve botërorë që t'i bashkojnë forcat për të "luftuar për paqe", duke thënë "le t'i ndërtojmë shpresat tona, në vend se të luajmë me frikë kundër njëri-tjetrit". "Shkatërrimi i kësaj shprese me një magjepsje për tërheqje, dhunë apo dominim, do të ishte një gabim për të cilin gjeneratat e ardhshme do të na bëjnë ne përgjegjës", shtoi presidenti francez. Macroni e përshkroi nacionalizmin si një "tradhti të patriotizmit".
Trumpi dhe Putini kanë shtrënguar duart kur lideri rus erdhi në ceremoni.
Më herët, teksa konvoji i Trumpit po udhëtonte nga Pallati Elize për në Harkun e Triumfit, një protestuese ka vrapuar drejt makinës me të cilën po udhëtonte Trumpi, përpara se të ndalohej nga policia. Sipas fotografive që kanë kapur momentin e këtij incidenti, protestuesja ka shkruar në trupin e vet "paqebërës i rremë".
Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, kancelarja gjermane Angela Merkel, presidenti rus Vladimir Putin, ai i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, janë në mesin e udhëheqësve botërorë që pritet të marrin pjesë në drekën e shtruar nga presidenti francez në Pallatin Elize.
Në ceremonitë për shënimin e 100-vjetorit të përfundimit të Luftës së Parë Botërore, me ftesë të Macronit, kanë marrë pjesë edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe homologu i tij serb, Aleksandar Vuçiq. Megjithatë, Thaçi në një konferencë për media nga Parisi një ditë më parë, ka thënë se nuk ka të planifikuar një takim me Vuçiqin në Paris.
Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është pritur në Pallatin Elize nga presidenti Macroni.
Më 10 nëntor, gjatë një darke morën pjesë shumë liderë. Presidenti Macron paralajmëroi se paqja po merret si e mirëqenë. "Disa nga ne kanë qenë në fronte të kundërta në atë kohë (gjatë Luftës së Parë Botërore) dhe ne jemi bashkuar sonte. Ky është homazhi më i madh që ne mund të bëjmë për ushtarët e vrarë", tha Macroni.

## Serbia zhvillon manovra ushtarake



BEOGRAD, 11 NËNTOR - Serbia zhvilloi manovra ushtarake për ta shënuar 100-vjetorin e përfundimit të Luftës së Parë Botërore, në një shpalosje të dukshme të forcës mes tensioneve në rritje me Kosovën. Manovrat, të titulluara "Shekulli i fituesve", përfshinin 8 000 ushtarë, 100 tanke dhe avionë luftarakë MiG-29 të furnizuar nga Rusia.
Presidenti serb Aleksandar Vuçiq, i cili ishte i pranishëm gjatë manovrave, tha se vendi i tij kishte përmirësuar ushtrinë për të pasur një efekt parandalues mbi sulmet e mundshme kundër tij.

# Sheri Blair, fillimet e vështira të karrierës si avokate

Sheri Blair bashkëshortja e ish kryeministrit britanik Toni Blair avokate e njohur e të drejtave të njeriut tregon në librin e saj me kujtime se fillimet e karrierës nuk kanë qenë të lehta. Të jesh grua që aspiron në një sistem të dominuar nga burrat duhet shumë guxim. Herët ajo u bashkua me Partinë Laburiste. Shpesh dëgjonte se gjykata ishte vend i egër për gratë.

Kur nisi të punonte në një studio ligjore bashkë me bashkëshortin e saj të ardhshëm interesin e saj ndaj politikës e dinin të gjithë Edhe Toni ishte anëtari i Partisë Laburiste në zonën e Uandsorthit, por nuk i kishte treguar askujt. " Me thënë të drejtën, në shumë aspekte, isha veçse një çupëlinë. Isha njëzetedy, por dukesha si dymbëdhjetë. Isha shumë hollake, përpara se kjo të ishte në modë. Nuk e kisha atë pragmatizëm që i karakterizonte ata që vinin nga shkollat private, gjë që manifestohej haptazi tek kolegët e mi, meshkuj e femra. Nuk më kishin mësuar asnjëherë kuptimin e fjalisë "maturia ka shumë vlerë". Me fjalë të tjera, nuk e dija se kur nuk duhej të hapja gojë. Murgeshat edhe mund ta kenë përmendur, por dukej sheshit se nuk kisha qenë e vëmendshme", shkruan Sheri. Ajo kujton se gjithnjë bëhej më e qartë se, për sa i përket marrjes së vendit të punë, pengesa më e madhe ishte gjinia: kisha seksin e gabuar.

"Atë vit, vetëm 16 % femra u pranuan në institucionet e avokaturës. Një vit më parë ishin marrë vetëm 9 % dhe vitin e mëparshëm edhe më pak. Ishte e vërtetë se përqindja po rritej, por qëndrimet dhe opinionet e avokatëve me përvojë – njerëzit që vendosnin për punën tonë të ardhshme – nuk kishin ndryshuar. Një nga librat shkollorë të vitit të parë ishte "Mësimi i ligjit", shkruar nga profesor Glanvill Uilliams, KM. Në botimin e vitit 1973, ai paralajmëronte vështirësitë e përfshirjes së femrave në sistemin gjyqësor.

"Ushtrimi i profesionit në gjykatë është një detyrë e vështirë për një burrë," shkruante ai. "Është akoma më e vështirë për një grua. Nuk është e lehtë për një të ri të përballet në sallën e gjyqit, ndërsa shumë femra nuk mund ta përballojnë. Zëri i një gruaje nuk dëgjohet si ai i një burri."

Këshilla e tij ndaj të sapodiplomuarave ishte: bëhuni konsulente ligjore", shkruan ajo. Blair nuk do ta harrojë kurrë momentin kur, pak kohë pasi ishte pranuar, u fut në një dhomë plot me burra me mantele. "Ata heshtën të shokuar e të tmerruar, kur e kuptuan se unë do të shkoja aty, do të vija parukën dhe do të vishja mantelin njëlloj si ata", shkruan Sheri Blair.

*(gazeta-Shqip.com)*



# Dashuria e tragjike e Amadeo Modiglianit

Jeanne Hébuterne është gruaja pas së cilës Amadeo Modigliani çoi mendimet e tij më të bukura. Por historia e tyre është një nga historitë më të bukurat e më tragjike të dashurisë. Vajza me sytë e zinj u fut në komunitetin e artistëve të Montparnasse nga i vëllai i cili dëshironte të bëhej piktor. Ajo u takua me artistë të njohur përfshirë këtu dhe Tsuguharu Foujita për të cilët punoi si modele. Pavarësisht punës që bënte Jeanne ëndërronte të studionte për pikturë pasi kishte talent në vizatimin. Ishte pranvera e vitit 1917 kur ajo u prezantua me Amedeo Modigliani. Ai ishte një burrë i pashëm i cili i tërhoqi menjëherë vëmendjen. Ata nisën menjëherë të dilnin me njëri tjetrin duke rënë në dashuri. Pavarësisht kundërshtimit të prindërve ajo u zhvendos për të jetuar me të.

Por jeta me Modigliani nuk ishte e lehtë. Ai ishte një njeri i varur nga alkoli dhe droga. Kjo varësi do të bënte që artisti të sëmurej nga tuberkulozi, i cili ishte dhe shkaku i vdekjes së tij.

Në vitin 1918 çifti u zhvendos për të jetuar në Nice në rivierën franceze duke menduar se tashmë pikturat Modiglianit do të shiteshin më lehtë. Në pranverë ata u kthyen sërish në Paris ku Jeanne mbeti shtatëzanë sërish. Më 24 janar 1920 Amedeo Modigliani vdiq nga turbekulozi. Familja u kujdes që ta merrte Jeanne në shtëpinë e tyre, por ajo nuk e përballoi dot ndarjen e tij nga jeta. Pesë ditë pas vdekjes së Modiglianit ajo u hodh nga dritarja bashkë me fëmijën e saj të palindur. Familja e saj fajësoi Modiglianin për vdekjen e së bijës. Dy të dashuruarit do të bashkoheshin në varr vetëm 10 vjet më vonë, ku qëndrimi i familjes së Jeanne u zbut. Në varrin e tyre shkruhet ky epitaf "Shoqërues i devotshëm për sakrificën ekstreme". *(gazeta-Shqip.com)*







E jashtëzakonshme

## Dreri i Babagjyshit të Krishtlindjeve përfundon në gjyq



Gjykata e Apelit në Torino është duke u marrë me një proces gjyqësor në lidhje me një dre. Ky dre ndodhet nën kujdestarinë e pronarit të një "parku kafshësh" në Monteu Roero (Cuneo). Në fakt, me ligj ai konsiderohet "i rrezikshëm". Në bazë të një leximi të kujdesshëm të aneksit A të një ligji të vitit 1996, drerët që i përkasin familjes Cervidae konsiderohen "të rrezikshëm", prandaj për ta mbajtur atë duhet një autorizim specifik.

FOTO E DITES



Flamingotë kërkojnë ushqim në një pellg afër Gan Shmuel në Izrael. /AP/

E rrallë

## Në Suedi mund të blini picë me banane



Pica suedeze është krejt tjetër nga ajo që jemi mësuar të hamë. Pothuajse shumica e restoranteve që shërbejnë picë që janë hapur në Suedi janë në pronësi të familjeve që nuk kanë rrënjë italiane. Për shkak të kërkesave, përbërës të pazakonshëm u shtuan në pica kurdo që kërkoheshin nga klientët. Më e fundit është pica me banane, një kombinim ky shumë i pazakontë dhe duket e tmerrshme.

## BARSOLETA E DITËS



**Shoqet:**
**- Ishe e sëmurë?**
**- Jo. Pse pyet?!**
**- Pashë doktorin që hynte e dilte shpesh nga dera juaj.**
**- Pse në shtëpinë tënde, që hynë e dalin ushtarë, luftë po bëhet?**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### "ALPHA" 3D,




Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

**Vetem gjate vikendit në ora 14:00**




Në ora 16:00

### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
**Regjia:** David Kerr

Në ora 18:00

### "NIGHT SCHOOL"




Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
**Regjia:** Malcolm D. Lee




Në ora 20:00

### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
**Regjia:** Matthew Ross

Në ora 22:00

### "VENOM" 3D,




Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Keni shumë çështje për të zgjidhur gjatë ditës së sotme. Pjesa e parë e ditës do të ketë aktivitete të shumta. Më e qetë mbrëmja.



**DEMI** Idetë që keni duhet t'i vini në veprim dhe t'i zhvilloni. Problemi i vetëm është se s'po gjeni pak kohë të lirë për ta bërë këtë gjë.



**BINJAKËT** Dikush po mundohet t'ju verë shkopinj nën rrota sot. Nëse keni autokontroll të mjaftueshëm do të dini si të dilni nga kjo situatë.



**GAFORRJA** Mund t'i lini gjërat të rrjedhin vetë. E rëndësishme është që në një moment të caktuar ju do ta keni kohën tuaj për të realizuar atë që doni.



**LUANI** Hap pas hapi do të arrini të mblidhni edhe ju sukseset tuaja. Shijoni çdo gjë që ju ofron jeta sepse e meritoni.



**VIRGJËRESHA** Në varësi të humorit do ta keni edhe sjelljen sot, por personat që ju rrinë pranë nuk e meritojnë arrogancën tuaj.



**PESHORJA** Jeni vëzhgues të mençur dhe sigurisht kjo gjë ju favorizon në shumë situata. Sot mendoni vetëm se si të relaksoheni.



**AKREPI** Sot nuk duhet të ekzagjeroni në kërkesa. Jo të gjitha gjërat që kërkoni mund të kenë kushte për t'u realizuar.



**SHIGJETARI** Mos kërkoni aventura sot sepse nuk do të mund ta përballoni dot rrezikun. Një sekret i kohëve më parë do t'ju shqetësojë.



**BRICJAPI** Indiferenca në shumë raste është arma më e mirë për të mos vuajtur. Jeta na rezervon çaste të dhimbshme që mund të na lëndojnë.



**UJORI** Konsideroni atë që ju thotë instinkti juaj i pagabueshëm sot. Mund të jetë momenti për një ndryshim të madh dhe total në jetën tuaj.



**PESHQIT** Sot do ta keni mundësinë t'i analizoni mirë ngjarjet që po ndodhin rreth jush. Paraqitet një ditë e qetë dhe pa shumë aktivitet.

# Rita Ora: Jeta ime seksuale është inekzistente



Rita Ora është një femër që ka arritur sukses të jashtëzakonshëm jo vetëm në tregun muzikor ndërkombëtar, por edhe në botën e modës. Ylli i popit është shfaqur si moderatore në ngjarje të mëdha muzikore, por ka qenë edhe imazh i shumë markave të njohura. Gjithashtu, këngëtarja po punon për nxjerrjen e albumit të dytë Phoenix, që i ka lënë shumë pak kohë për romancë. 27-vjeçarja ka zbuluar se jeta e saj seksuale tani nuk ekziston. "Jeta ime seksuale është inekzistente. Po punoj kaq shumë dhe vetëm fle gjumë", ka thënë Rita në një intervistë për "British Vogue".



# Kate Upton sjell në jetë fëmijën e parë

Kate Upton ka sjellë në jetë fëmijën e parë me bashkëshortin Justin Verlander. Lajmin e ka konfirmuar modeluesja 26-vjeçare e "Vogue"-s në "Instagram". Modeluesja nga Michigan dhe bashkëshorti i saj, lojtari i baseball Houston Astros, 35 vjeç, duken më të dashuruar se kurrë teksa kanë festuar përvjetorin e parë të martesës në të njëjtën ditë.

# Lady Gaga rrëfen problemet mendore: Nuk thosha dot 'jo'



Këngëtarja Lady Gaga nuk ka hezituar asnjëherë që të tregojë të vërtetën. Ajo u nderua me një çmim për pjesëmarrjen në "A Star Is Born" dhe gjatë fjalimit foli për problemet mendore që ka kaluar gjatë jetës. Gjendja e rënduar psikologjike e detyroi që të kërkojë ndihmë për trajtim. Lodhja që merrte nga aktivitetet e shumta ishte gati që t'i merrte jetën. "Pas shumë vitesh që i thosha 'po' punës, intervistave, ngjarjeve, të gjitha mundësive, për ta cilat pa dyshim jam shumë mirënjohëse dhe pasi punova aq fort sa munda për t'i arritur ëndrrat e mia, fjala 'po' u kthye në diçka automatike. Zëri im i brendshëm u fik dhe kjo gjë nuk është e shëndetshme. Unë nuk kisha fuqinë të thosha 'jo'", ka thënë këngëtarja.

# Nicole Kidman flet për herë të parë për fëmijët adoptiv me Cruise



"Janë të rritur dhe janë në gjendje t'i marrin vendimet e tyre. Kanë zgjedhur Scientology dhe si nënë është detyra ime t'i dua", kështu Nicole Kidman tregon për Isabella dhe Connor, fëmijët adoptiv me ish-bashkëshortin Tom Cruise. Ajo tregon në një intervistë për revistën australiane "Who" për një argument për të cilin është shprehur shumë rrallë deri tani. "E di 150 për qind që do të hiqja dorë nga jeta ime për fëmijët e mi, sepse ky është qëllimi im në jetë", kështu e shpreh dashurinë për fëmijët 23 dhe 25 vjeç aktorja të cilët tani thotë se i takon rrallë.




# Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | |
|---|---|---|
| VFL BOCHUM - DARMSTADT | 1 | |
| BRESTOIS - NANCY | 3+ | |
| OLIVEIRENSE - VARZIM | 1 | |

# Prishtina ruan kryesimin, Llapi e mposhti kampionen

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 NËNTOR - Janë zhvilluar pesë prej gjashtë ndeshjeve të javës së 15-të në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Prishtina e mposhti Ballkanin dhe në këtë mënyrë e ruan pozitën e parë në renditjen tabelore. Ndërsa derbin e xhiros e ka fituar skuadra e Llapit në përballje me kampionët e Dritës. Fitore të rëndësishme arriti edhe Gjilani ndaj Drenicës, kurse ndeshja e fundit për këtë xhiro zhvillohet sot (e hënë) në mes të Feronikelit dhe Ferizajt. E veçanta e kësaj xhiroje është se në pesë ndeshjet e zhvilluara vendësit kanë arritur pesë fitore.



### Prishtina - Ballkani 2-0

Prishtina e arriti një fitore tjetër të rëndësishme në elitë, pasi e mposhti Ballkanin në ndeshjen e zhvilluar të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" me rezultat 2-0. Mysafirët nga Suhareka u mbajtën mirë në pjesën e parë, por në pjesën e dytë të ndeshjes ishin vendësit që shënuan dy gola të shpejtë për t'i marrë tri pikët e plota. Fillimisht për 1-0 realizoi Marjo Morina në minutën e 65-të dhe dy minuta më vonë realizoi Meriton Korenica për 2-0, pas një gjuajtje të fortë nga largësia. Pas kësaj ndeshje Prishtina është e para me 36 pikë, kurse Ballkani është i nënti me 18 pikë.

### Gjilani - Drenica 1-0

Fitore tepër të rëndësishme ka shënuar të dielën edhe skuadra e Gjilanit, e cila e ka mposhtur Drenicën me rezultat minimal 1-0. Vendësit e kërkuan me ngulm golin e fitore, por një gjë të tillë e arritën vetëm gjashtë minuta pa përfunduar ndeshja, kur realizoi Vilfor Hysa. Gjilani pas këtyre tri pikëve pozicionohet në pozitën e katërt me 24 pikë, kurse Drenica është e teta me 18 pikë.

### Trepça '89 - KEK-u 4-1

Të dielën fitoren e tretë si skuadër vendëse e realizoi Trepça '89 e cila e mposhti KEK-un me rezultat 4-1. Të parët në epërsi kaluan mysafirët me golin e Ardit Gashit në minutën e 8-të, por tre minuta më vonë rezultatin e barazoi Ergys Mersini. Mysafirët rezistuan në pjesën e parë, por në pjesën e dytë 89-shi e ngriti ritmin e lojës dhe shënoi tre gola për fitore në këtë ndeshje. Gëzim Rusi realizoi në minutat 49 dhe 50, kurse rezultatin 4-1 e vulosi Arb Manaj me golin e shënuar tre minuta pa përfunduar ndeshja.

### Llapi - Drita 1-0

Të shtunën fitore me rezultat 1-0 arriti skuadra e Llapit në derbin ndaj Dritës së Gjilanit, e cila është kampione aktuale e IPKO Superligës së Kosovës në futboll. "Hero" i llapjanëve edhe një herë është treguar Festim Alidema, i cili e shënoi golin e vetëm në ndeshje në fund të pjesës së parë. Llapi pas kësaj fitore e ruan hapin me dy skuadrat e para në tabelën e klasifikimit, Prishtinën dhe Feronikelin.

### Liria - Flamurtari 1-0

Fitore si vendëse arriti edhe Liria ndaj Flamurtarit (1-0). Pjesa e parë u mbyll me rezultat 0-0, kurse në pjesën e dytë prizrenasit shënuan golin e tri pikëve në minutën e 67. Autor ishte Fatih Karahoda. Pas xhiros së pesëmbëdhjetë, Liria ka grumbulluar 16 pikë. Flamurtari, që është një prej skuadrave më të mira në këtë kampionat, mbetet në kuotën e 22 pikëve dhe renditet në pozitën e gjashtë.

**IPKO Superliga**

| | |
|---|---|
| Prishtina - Ballkani | 2-0 |
| Gjilani - Drenica | 1-0 |
| Trepça '89 - KEK-u | 4-1 |
| Llapi - Drita | 1-0 |
| Liria - Flamurtari | 1-0 |

Të hënën takohen:
Feronikeli - Ferizaj

**Tabela**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Prishtina | 15 | 36 pikë |
| 2. Feronikeli | 14 | 32 |
| 3. Llapi | 15 | 29 |
| 4. Gjilani | 15 | 24 |
| 5. Drita | 15 | 22 |
| 6. Flamurtari | 15 | 22 |
| 7. Trepça '89 | 15 | 19 |
| 8. Drenica | 15 | 18 |
| 9. Ballkani | 15 | 18 |
| 10. Liria | 15 | 16 |
| 11. Ferizaj | 14 | 14 |
| 12. KEK-u | 15 | 1 |

**LIGA E PARË**

| | |
|---|---|
| Besa - Vëllaznimi | 2-0 |
| Vllaznia - Fushë-Kosova | 2-2 |
| Vitia - Kika | 2-1 |
| Bashkimi (K) - Ramiz Sadiku | 2-4 |
| Vushtrria - Dukagjini | 1-0 |
| 2 Korriku - Drenasi | 2-1 |
| Trepça - Arbëria | 2-0 |
| Istogu - Onix | 0-3 |

**Tabela**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Besa | 13 | 30 pikë |
| 2. Vushtrria | 13 | 29 |
| 3. Dukagjini | 13 | 24 |
| 4. Vitia | 13 | 24 |
| 5. Vëllaznimi | 13 | 23 |
| 6. Onix | 13 | 22 |
| 7. Trepça | 13 | 20 |
| 8. Arbëria | 13 | 18 |
| 9. Istogu | 13 | 17 |
| 10. Ramiz Sadiku | 13 | 15 |
| 11. 2 Korriku | 13 | 14 |
| 12. Kika | 13 | 13 |
| 13. Fushë-Kosova | 13 | 13 |
| 14. Drenasi | 13 | 12 |
| 15. Bashkimi (K) | 13 | 9 |
| 16. Vllaznia | 13 | 8 |

## SHKURT

### KB Prishtina të martën pret Steauan

Klubi i Basketbollit, Prishtina, të martën do të ketë ndeshjen e radhës në kuadër të FIBA Europe Cup ndaj kampionit të Rumanisë, Steaua Bucuresti. Kjo ndeshje është në kuadër të xhiros së pestë të Grupit E në FIBA Europe Cup, nga i cili grup Prishtina ka siguruar kualifikimin tutje. Pas Steauas, Prishtina do të luajë edhe me Bakken Bears. Të dy ndeshjet i zhvillon si vendëse. Pas katër ndeshjeve të zhvilluara deri tash, Prishtina ka siguruar matematikisht plasmanin në mesin e 16 më të mirëve.

### Grezda shënon dy gola për Rangersin

Reprezentuesi i Shqipërisë, Eros Grezda, ka shënuar golat e parë në fanellën e skuadrës se Rangersit. Mesfushori ofensiv ka shënuar golin e gjashtë dhe të shtatë për Rangersin në ndeshjen që kjo skuadër e fitoi ndaj Motherwellit me rezultat 7-1. Dy gola të tjerë i shënoi Scott Arfield, kurse nga një e shtuan Glenn Middleton, Alfredo Morelos dhe James Tavernier.

### Fitore të reja për Prishtinën dhe Rahovecin

KB Prishtina ka shënuar fitore bindëse në udhëtim te Trepça. Klubi nga kryeqyteti shënoi fitore bindëse me rezultat prej 83:106. Fitore ka shënuar edhe KB Rahoveci kundër Boreas në kuadër të Superligës së Kosovës në basketboll. "Vreshtarët" shënuan fitore me rezultat prej 103:90.

### Shënon Shaqiri

Liverpooli ka shënuar fitore në Premierë Ligë ndaj Fulhamit (2-0). Goli i Salahit në minutat e fundit të pjesës së parë dhe finalizimi i Xherdan Shaqirit në fillimin e pjesës së dytë u mjaftuan "The Reds"-ave për t'i marrë tre pikë të rëndësishme në garën për titull.

### Loriana Kuka, e artë në Uzbekistan

Loriana Kuka ka vazhduar suksesin e ekipit të xhudos në Grand Prixin e xhudos, që po mbahet në Tashkent të Uzbekistanit. Xhudistja Kuka e fitoi medaljen e artë në kategorinë deri 78 kilogramë, duke çuar në katër numrin e medaljeve të fituara nga xhudistet e Kosovës, prej tyre tri të arta dhe një e argjendtë. Një sukses i tillë nuk ishte arritur asnjëherë më parë. Majlinda Kelmendi (-52 kg), Distria Krasniqi (-48 kg) fituan të premten të artën, ndërsa Nora Gjakova (-57 kg) të argjendtën. Kampionia e Evropës U-23, Loriana Kuka, fitoi të artën, pasi në finale mposhti austriaken Bernadette Graf. Në përgjithësi, Kuka shënoi katër fitore, të gjitha me Ippon dhe një pa luftë. Ky sukses, që vjen një javë pas shpalljes kampione e Evropës U-23, i sjell Lorianës 700 pikë olimpike, për ta vazhduar suksesshëm garën për normën olimpike "Tokyo 2020".

## City i tregon Unitedit se kush është kampioni

MANCHESTER, 11 NËNTOR - Manchester City e ka fituar derbin e Premierë Ligës ndaj Manchester Unitedit me rezultat 3-1 dhe në këtë mënyrë ia ka konfirmuar kësaj skuadre se kush është kampioni në Angli. David Silva në minutën e 12 realizoi për 1-0. Me këtë rezultat përfundoi pjesa e parë, kurse në fillim të pjesës së dytë vendësit e dyfishuan epërsinë në 2-0 nëpërmjet Sergio Agueros. Martial e ngushtoi epërsinë në 2-1 me golin e shënuar nga penalltia, kurse rezultatin final 3-1 e vulosi Ilkay Gundogan. Në ndeshjen tjetër Arsenali nuk ka arritur të marrë më shumë se një pikë në ndeshjen ndaj Wolverhampton Wanderersit, pasi rezultati final ishte 1-1. Në minutën e 13 Ivan Cavaleiro shënoi për mysafirët, kurse për vendësit realizoi Henrikh Mkhitaryan katër minuta para fundit.



## Drejtuesit e KOK-ut morën pjesë në Asamblenë Gjenerale të EOC-ut

PRISHTINË, 10 NËNTOR - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Besim Hasani dhe sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj, kanë marrë pjesë në Asamblenë e 47-të Gjenerale të Komitetit Olimpik të Evropës, e cila po mbahet në Marbella të Spanjës. Në Asamble, krahas drejtuesve më të lartë të EOC-ut dhe Komiteteve Olimpike të Evropës, i pranishëm ishte edhe presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach, i cili foli për nevojën për ta mbrojtur Modelin Evropian të Sportit. Në fjalën e tij, presidenti i EOC-ut, Janez Kocijaniq, ka thënë se kontinenti i Evropës është më i forti, në kuptimin e 50 për qind të medaljeve të fituara në Lojërat Olimpike Verore dhe mbi 70 për qind të medaljeve të fituara në Lojërat Olimpike Dimërore. Ndër temat e shumta që u diskutuan janë Lojërat Olimpike "Tokyo 2020", Lojërat Evropiane "Minsk 2019", Festivali Evropian Dimëror për të Rinj, Sarajeva 2019, Festivali Evropian Veror për të Rinj,




